

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6093
E premtë, 21 gusht 2020
çmimi 0.40 €



FLET PËR "EPOKËN E RE", NIK GJELOSHAJ | FAQE 4-5



Haradinaj-Stublla:
Kosova do të mund ta
dërgojë një përfaqësues
në DASH | FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



SYNOJMË DY MANDATE NË KUVENDIN E MALIT TË ZI

- Pa përfaqësim autentik
nuk ka as zgjidhje
të kërkesave tona

Bartësi i Listës Shqiptare për zgjedhjet e 30 gushtit në Mal të Zi, Nik Gjeloshaj, është shprehur i bindur në suksesin e kësaj liste. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ky koalicion do

t'i fitojë dy mandate në parlament. Sipas tij, këto mandate do tëjenë vendimtare për krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve. Gjeloshaj, i cili është kryetar i Komunës së Tuzit, i ka ftuar shqiptarët që të dalin në

numër sa më të madh në këto zgjedhje, duke thënë se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për shqiptarët. Ai ka thënë se pa përfaqësim autentik nuk ka as zgjidhje të kërkesave të shqiptarëve

QALAJ VËZHGOR AKTIVITETET E POLICISË, BËN THIRRJE PËR KUJDES NË KOMUNIKACION

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka dalë të enjten në terren për ta parë nga afér zbatimin e planeve dhe të aktiviteteve policore. Në periudhën janar-qershor të këtij viti në aksidente trafiku kanë vdekur 15 persona më pak se në

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Policia u ka bërë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafik që t'i respektojnë rregulat e trafikut rrugor dhe t'u përshtaten kushteve dhe rrethanave të trafikut me qëllim të shambahes së aksidenteve dhe rritjes së sigurisë në trafik



13 TË VDEKUR DHE 158 RASTE TË REJA
ME COVID-19 NË KOSOVË | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endri Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

OPINION

UÇK-JA KA QENË UNIKE
DHE ME DISIPLINË TË
NDËRGJEGJSHME (32) | F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA

AKTUALE

ZGJEDHJA E AVOKATIT
TË POPULLIT RREZIKON TË
KTHEHET NË PIKËN ZERO | F. 7

INSPEKTORATI ANULON
VENDIMIN PËR SHKARKIMIN E
BASRI SEJDIUT NGA POZITA E
DREJTORIT TË SHSKUK-së | F. 7

EKONOMI



HOTI: NË SHTATOR FILLON
ZBATIMI I PLANIT PESËVJEÇAR
PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE | F. 9

MINISTRIA E BUJQËSISË ZGJAT
DERI MË 28 GUSHT AFATIN E
APLIKIMIT PËR GRANTE | F. 8

KULTURË

DUMOSHI: DERA E MKRS-SË
ËSHTË PËRHERË E HAPUR PËR
KOMUNITETIN BOSHNJAK | F. 16

SPORT

SHTYHET PËR TË PREMTEN
NDESHJA TRE PENNE - GJILAN

| F. 18

Kamala Harris, edhe zyrtarisht kandidate demokrate për nënresidente


UASHINGTON, 20 GUSHT - Senatorja amerikane Kamala Harris ka pranuar nominimin e Partisë Demokratike për të garuar në pozitën e nënresidentes përmes një ceremonie virtuale në të cilën ka kritikuar "mungesën e kompetencës" dhe "ashpërsinë" e presidentit amerikan Donald Trump. Harris ka bërë historinë më 19 gusht, meqë është gruaja e parë amerikane me ngjyrë që synon të bëhet nënresidente e Shteteve të Bashkuara.

Nominimi i saj është bërë në natën e tretë të Konventës Kombëtare të Demokratëve, e cila është mbajtur tërësisht në versionin online për shkak të pandemisë me koronavirus. Ajo do të garojë bashkë me ish-nënresidentin amerikan Joe Biden në zgjedhjet presidenciale të 3 nentorit. Harris ka përmendur mësimet e nënës së vet, biologe, që ka emigruar nga India, duke thënë se ajo i ka krijuar një vizion për Shtetet e Bashkuara si komunitet "ku të gjithë janë të

mirëpritur, pavarësish asaj si duken, prej nga vijnë apo kë e duan". Senatorja amerikane, babai i së cilës është nga Xhamajka, e ka akuzuar Trumpin për "dëshitim në udhëheqësi" përgjatë periudhës së kooronavirusit. Presidenti aktual, Donald Trump, synon të fitojë një tjetër mandat presidencial, bashkë me Mike Pence në pozitën e nënresidentit. Ai pritet të nominohet edhe zyrtarisht nga Partia Republikane javën e ardhshme.



Gjermania thotë se mund ta përballojë numrin në rritje të të infektuarve



BERLIN, 20 GUSHT - Autoritetet shëndetësore të Gjermanisë aktualisht mund ta përballojnë rritjen e numrit të të infektuarve me Covid. Kështu i ka thënë agjencisë "Reuters", zëvendësdrejtori i Institutit për Sëmundje Infektive "Robert Koch". Numri i rasteve të reja në Gjermani është rritur në javët e fundit. Autoritetet kanë thënë se faktorë të kësaj rritjeje janë kthimet nga pushimet, organizimet e festive dhe mbledhjet e tjera familjare. Të enjten numri i rasteve të konfirmuara me koronavirus ishte 1 707, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të infektuarve në 228 621. "Për momentin, numrat po rriten pak më ngadalë sesa në pranverë, kjo është mirë - por për sa kohë që ato po rriten, sigurisht se nuk është një zhvillim i këndshëm", ka thënë Lars Schaade. Ai u ka bërë thirrje njerëzve të mos udhëtojnë në vendet me rrezik të lartë dhe t'i përbahen distancimit fizik si dhe rregullave të higjenës. Pothuajse gjysma e rasteve të regjistruara nga Institut "Robert Koch" ishin të kthyerit nga pushimet, ka thënë Schaade. Kujtojmë se Gjermania ka lëshuar një paralajmërim kundër udhëtimit në disa pjesë të Kroacisë.

Kritiku i Kremlinit, Aleksei Navalny, dyshohet se është helmuar

MOSKË, 20 GUSHT - Kritiku i zëshëm i Kremlinit, Aleksei Navalny, gjendet në kujdes intensiv në një spital në Omsk, ku po trajtohet për helmim potencial, ka thënë zëdhënësja e tij, Kira Yarmysh. Navalny nuk është ndier mirë teksa është kthyer në Moskë nga qyteti siberian, Tomsk, që ka rezultuar me ulje të paplanifikuar të aeroplanit në Omsk, po ashtu në Siberi, ka thënë Yarmysh.

Navaly është "pavetëdije", ka thënë ajo. Sipas agjencisë së lajmeve "TASS", mjeku Aleksandr Murakhovsky ka thënë se Navalny është "në gjendje të rëndë". "Ne dyshojmë se Aleksei është helmuar me diçka të përzier në çaj. Ajo ka qenë gjëja e vetme që ka pirë në mëngjes. Mjekët thonë se toksina ka reaguar më shpejt përmes ujit të ngrohtë", ka thënë Yarmysh.

Navalny, kritik i madh i presidentit rus, Vladimir Putin, ka bërë përpjekje për shpërfaqje të korrupsionit në Rusi. Ai është burgosur disa herë në vjetët e fundit si dhe i është ndaluar të garojë për president, apo për kryetar të Moskës. Yarmysh ka thënë se Navalny është helmuar edhe vitin e kaluar kur ka qenë në një qendër të paraburgimit. "Ata i kanë bërë të njëjtën gjë edhe tanë", ka dekluaruar ajo.



Arrestohet i kërkuar për krime lufte nga Kroacia



FRANKURT, 20 GUSHT - Policia federale në Gjermani ka bërë me dije se ka arrestuar një 55-vjeçar nga ish-Jugosllavia i cili ishte dënuar para 23 vjetëve në Kroaci për krime kundër njerëzimit dhe nuk e kishte vuajtur asnjëherë

dënimin. I arrestuari, tani qytetar amerikan, ishte dënuar në vitin 1997 me dënim prej 10 vjetëve burgim për vrashjen e një personi civil në vitin 1993 gjatë luftës në Kroaci. Policia gjermane tha se vrasha kishte

ndodhur gjatë kohës sa ai ishte pjesë e ushtrisë së Krajinës-territori kroat, në vitet 1990. Që nga ajo kohë, personi i arrestuar, emrin e të cilit policia gjermane nuk e bëri publik për shkaqe privatezie, kishte arritur t'i ikte

drejtësisë. Ai është arrestuar në aeroportin e Frankfurtit të hënën derisa ishte duke udhëtar nga Çikagoja për në Beograd. Aktualisht ai po mbahet nga autoritetet gjermane deri në ekstradimin e tij në Kroaci.

Haradinaj-Stublla: Kosova do të mund ta dërgojë një përfaqësues në DASH



Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka bërë me dije të enjten se Kosova për herë të parë do të mund ta dërgojë një përfaqësues të ministrisë që ajo drejtton në Departamentin Amerikan të Shtetit. Ajo ka thënë se kjo gjë i është konfirmuar gjatë një takimi që ka pasur me zëvendësndihmëssekretarin për Çështje Evropiane dhe të Euroazisë, Matthew Palmer

USAID-i MBETET PARTNER I QËNDRUESHËM I KOSOVËS

Në kuadër të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i Drejtësisë, Selimi Selimi, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesin e lartë të USAID për Evropën dhe Euroazinë, Brock Bierman. Ministri Selimi vlerësoi lart kontributin e USAID-it, me theks të veçantë në fushën e

drejtësisë dhe për avancimin e infrastrukturës ligjore, ndërsa tha se ky mision mbetet partner i qëndrueshëm i Republikës së Kosovës. "Shtetet e Bashkuara i kanë qëndruar në krah Kosovës në kohët më të vështira dhe po na qëndrojnë afér edhe sot, me ndihmën dhe mbështetjen e pakursyer në të gjitha fushat për zhvillim dhe fuqizim të shtetit. Roli i USAID-it në Kosovë është i rëndësishëm së veçantë", ka thënë ministri Selimi.

Gjatë takimit, ministri Selimi ka folur për priorititetet e Ministrisë së Drejtësisë, për agjendën

EPOKA ERE Qendresa RAMA

WASHINGTON, 20 GUSHT - Republika e Kosovës për herë të parë në historinë e vet do të mund ta dërgojë përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Departamentin Amerikan të Shtetit (DASH). Këtë ia ka konfirmuar ministres Meliza Haradinaj-Stublla vetë zëvendësndihmëssekretari për Çështjet Evropiane dhe të Euroazisë, Matthew Palmer, gjatë takimit që kanë zhvilluar së bashku në Uashington. "Koordinimi i ngushtë i politikës sonë të jashtme me ShBA-në dhe profesionalizimi i shërbimit të jashtëm sipas

praktikave më të larta ndërkombëtare, mbeten prioritet tonë", ka deklaruar ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës. Ajo ka bërë me dije se me Palmerin kanë biseduar edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Diskutuam me z. Palmer edhe për dialogun me Serbinë, ku bashkë me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, theksuan se vetëm nën lidershipin amerikan, dialogu do ta ketë dinamikën dhe qartësinë e duhur për t'u përmbyllur me njohje reciproke në kufijtë ekzistues, duke ruajtur karakterin unitar dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës", ka thënë kryediplomatja e Kosovës.



Veliu dhe Selmanaj bisedojnë për agjendën legjislative

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka pritur të enjten në takim zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin rrëth aktiviteteve qeveritare, me theks të veçantë për agjendën legjislative. Me këtë rast, Veliu ka

vënë në dukje nismat ligjore që ka ndërmarrë MPB-ja, disa prej të cilave janë në procesin e hartimit dhe disa në plotësim-ndryshim. Ai ka thënë se me këto ligje synohet të përmirësohet fushëveprimtaria e kësaj ministrie, me qëllim që të përmirësohen dhe avancohen

shërbimet ndaj qytetarëve. Gjatë këtij takimi është vlerësuar se, pavarësisht prej sfidave me të cilat po ballafaqohet Qeveria e Kosovës sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19, gjendja e përgjithshme e sigurisë në tërë vendin është brenda parametrave normalë.





Flet për "Epokën e re", Nik Gjeloshaj

Synojmë dy mandate në Kuvendin e Malit të Zi

- Pa përfaqësim autentik nuk ka as zgjidhje të kërkesave tona

Bartësi i Listës Shqiptare për zgjedhjet e 30 gushtit në Mal të Zi, Nik Gjeloshaj, është shprehur i bindur në suksesin e kësaj liste. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ky koalicion do t'i fitojë dy mandate në parlament. Sipas tij, këto mandate do të janë vendimtare për krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve. Gjeloshaj, i cili është kryetar i komunës së Tuzit, i ka ftuar shqiptarët që të dalin në numër sa më të madh në këto zgjedhje, duke thënë se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për shqiptarët. Ai ka thënë se pa përfaqësim autentik nuk ka as zgjidhje të kërkesave të shqiptarëve

EPOKA ERE Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 20 GUSHT - Bartësi i Listës Shqiptare për zgjedhjet e 30 gushtit në Mal të Zi, Nik Gjeloshaj, ka ftuar shqiptarët e kësaj anë që të dalin në numër sa më të madh në zgjedhje. "Presim që 'Lista Shqiptare Genci Nimanbegu-Nik Gjeloshaj' do të korri sukses në zgjedhjet e 30 gushtit duke i fituar dy mandate. Ashtu flasin edhe sondazhet e bëra ditët e fundit. Dy mandate shqiptare mund të janë vendimtare në konstelacionin politik që do të krijohet pas zgjedhjeve. Të gjithë shprehur i bindur se kjo listë do të fitojë dy deputetë në Parlamentin e Malit të Zi.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Gjeloshaj ka

elementit malazias-serb në Mal të Zi. Unë nuk pres lëkundje tektonike në këtë skenë, por të jesh vendimtar me votën tënde di të jetë me interes shumë të madh për ne shqiptarët", ka thënë ai. Gjeloshaj ka vlerësuar se përfaqësuesit e këtij koalicioni dinë më se miri t'i mbrojnë të drejtat e shqiptarëve në këtë shtet. "Kemi dëshmuar si në rrafshin lokal, si në atë shtetëror, se angazhimi ynë merr frymë shqip, se dimë me një dinjitet të palëkundshëm t'i mbrojmë interesat e shqiptarëve, se nuk bëjmë kompromise të kalbura dhe as tregti me çështjen tonë kombëtare", është shprehur ai.

Gjeloshaj, i cili është kryetar i Komunës së Tuzit, beson se bashkimi i këtyre subjekteve politike shqiptare në një listë të përbashkët do të ndikojë në daljen masive të shqiptarëve në zgjedhje. "Ne besojmë në vetëdijen e ngritur të qytetarëve tanë. Për veprimitarë e deritashme presim votëbesim, pikërisht siç kemi qenë të gatshëm edhe gjatë mandatit të fundit (kur kishim vetëm një deputet, por kur rezultatet ishin më se të dukshme) të pranojmë edhe sugjerime, por pse jo edhe kritika. Presim që shqiptarët të dalin në vota në numër sa më të madh", është shprehur Gjeloshaj.

"**Epoka e re**": Z. Gjeloshaj, për zgjedhjet e 30 gushtit keni

nënshkruar një marrëveshje koalicionit gjithëpërfshirës me disa subjekte të tjera politike. Megjithatë, nuk ndodhi bashkimi i të gjitha partive politike shqiptare në një listë të përbashkët. Pse?

Gjeloshaj: Me punën, angazhimin dhe politikën tonë parimore të deritanishme, besoj se kemi treguar se askush nuk i përfaqëson dhe nuk lufton për të drejtat tona individuale dhe kolektive sa përfaqësuesit tanë, përfaqësuesit autentikë, pra deputetët nga partitë shqiptare. Me koalicionin tonë "Lista Shqiptare" kemi treguar se deklarimet tona për bashkimin e subjekteve shqiptare nuk janë floskula. T'ju përkujtoj se ne kemi pritur deri në çastin e fundit pa e shpallur koalicionin, vetëm me dëshirë që të dalim si një listë gjithëpërfshirëse.

"**Epoka e re**": Çfarë pritni nga ky bashkim i forcave?

Gjeloshaj: Pritja më reale për këtë bashkim është vota e shqiptarëve, është besimi që presim se do të na jepim shqiptarët për t'i përfaqësuar në strukturat shtetërore të Malit të Zi, që nga parlamenti, qeveria, ministritë e ndryshme e deri në çdo pore të jetës institucionale. Pa përfaqësim autentik nuk ka as zgjidhje të kërkesave tona. E kujt tjetër t'i jepet vota, nëse jo ne? Ne jemi ata që shtrihemi që nga

bregu i Bunës deri në Dacaj të Rozhajës. Që kemi dëshmuar si në rrafshin lokal, si në atë shtetëror, se angazhimi ynë merr frymë shqip, se dimë me një dinjitet të palëkundshëm t'i mbrojmë interesat e shqiptarëve, se nuk bëjmë kompromise të kalbura dhe as tregti me çështjen tonë kombëtare.

"**Epoka e re**": Motoja juaj është "Koha është tani". Çfarë do të thotë kjo moto?

Gjeloshaj: Motoja jonë "Koha është tani" përmblledh shumë mendime dhe mesazhe brenda. Falë veprimitarë sonë të deritashme ne kemi arritur të zgjidhim shumë kërkesa tona identitare, që rrinin pezull, as andej, as këndeje, me dekada të tëra. Shumë kërkesa tona që as nuk vini në rend të ditës, i kemi vënë adacta. Besojmë se koha është tani të merremi me çështje ekonomike, për ta ngritur standardin jetësor të shqiptarëve tanë. Koha është tani të merremi me ekonominë, me turizmin, me bujqësinë, me të gjitha ato çështje që e lehtësojnë jetën e qytetarëve tanë, që ndërpresin procesin e asimilimit, shpërndarjen dhe apatisë. Koha është tani të krijojmë vende të reja të punës me resurset tona, që qëllimisht janë lënë pas dore me dekada. Koha është tani t'i tregojmë të gjitha kapacitetet krijuarës në çdo fushë, por këto



reja kufitare dhe rrugët përkatëse drejt Shqipërisë dhe Kosovës; punësimi i të rinjve tanë dhe përfaqësimi i drejtë të shqiptarëve në administratën shtetërore; kthimi i pronave; rritja e cilësisë dhe modernizimi i infrastrukturës së shkollave shqipe; zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe shërbimeve shëndetësore në trevat shqiptare; turizmi bregdetar, rural, malor, turizmi dimërор dhe bujqësia; ringjallja e jetës kulturore e sportive.

"Epoka e re": Po përliritë dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve çfarë do të bëni?

Gjeloshaj: Thashë edhe më sipër, preokupimi ynë kryesor është ta ruajmë popullin shqiptar në Mal të Zi si pjesë e pandarë e kombit shqiptar në tërësi. Çështja e të drejtave dhe lirive të njeriut është çështje e rëndësishme e integrimeve evropiane. Shqiptarët jemi me siguri kombi më proevropian jo vetëm në Ballkan. Partnerët në ruajtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si atyre individuale, ashtu edhe kolektive kemi BE. Mali i Zi pretendon të hyjë në familjen e shteteve më progresive - në BE, prandaj edhe tek ato forca politike do të kërkojmë, e nuk kam dyshim se do ta gjejmë partneritetin e duhur.

"Epoka e re": Cilat janë pritet tuaja përkëto zgjedhje?

Gjeloshaj: Presim se "Lista Shqiptare Genci Nimanbegu-Nik Gjeloshaj" do të korri sukses në zgjedhjet e 30 gushtit duke i fituar dy mandate. Ashtu flasin edhe sondazhet e bëra ditëve të fundit. Dy mandate shqiptare mund të janë vendimtare në konstelacionin politik që do të krijohet pas zgjedhjeve. Të gjithë e shohim ndarjen si me thikë të elementit malazias-serb në Mal të Zi. Unë nuk pres lëkundje tektonike në këtë skenë, por të jesh vendimtar me votën tëndë di të jetë me interes shumë të madh për ne shqiptarët. Është më lehtë të kërkosh, t'i realizosh të drejtat tua, të imponosh ide.

"Epoka e re": Cili është mesazhi juaj për shqiptarët më 30 gushtin?

Gjeloshaj: Mesazhi është i qartë. Dilni të gjithë në vota dhe votoni listën zgjedhore që i prezanton më së miri të drejtat interesat tuaja, si ato individuale, ashtu edhe kolektive. Ne jemi të bindur se zgjedhja juaj do të jemi ne - Lista Shqiptare. Vetëm mendoni se kush janë ata që ngriten zérin për çështjet e simboleve kombëtare, për ruajtjen e figurave kombëtare dhe historisë sonë të ndritur, kush janë ata që angazhohen për lidhjet e fortë me shqiptarët në shtetet e tjera, Shqipëri dhe Kosovë dhe gjithkund ku gjendet shqiptarët. Jemi pikërisht ne! Andaj, votuesit i mbetet të votojë me zemër të pastër dhe me arsyë të ftohtë. Edhe numri 10 është simbolikë e jona.

kapacitete duhet të dalin në drithë me mbështetjen institucionale. Ka shumë punë që na presin, sepse veprimitaria janë nuk është ad-hoc, është një proces i gjallë, dhe "koha është tanë" ta avancojmë këtë proces.

"Epoka e re": Sa prisni që ky bashkim ta rritë votën shqiptare?

Gjeloshaj: Ne besojmë në vetëdijen e ngritur të qytetarëve tanë. Për veprimitarinë e deritashme presim votëbesim, pikërisht siç kemi qenë të gatshëm edhe gjatë mandatit të fundit (kur kishim vetëm një deputet, por kur rezultatet ishin më se të dukshme) të pranojmë edhe sugjerime, pse jo edhe kritika. Presim që shqiptarët të dalin në vota në numër sa më të madh. Mosdalja në vota, kuptohet është e drejtë e secilit, por ajo nuk i ndihmon çështjes shqiptare në Mal të Zi. Nëse këtu llogarisim "votat e sigurta" të partive të tjera brenda komunitetit shqiptar, mosdalja në vota është ndëshkim, sipas nesh, i pamerituar për koalicionet shqiptare, për vetë shqiptarët.

"Epoka e re": Çfarë përmban ofertët e tjerë?

Gjeloshaj: Si gjithkund në botë, të drejtat identitare janë themel i veprimit të partive nacionale. Ashtu edhe te ne këto të drejta janë prioritet i të gjithë prioriteteve, por në platformën tonë zgjedhore që e prezantuanë disa ditë përparrë, janë dhjetë shtylla të saj që do t'i kemi udhërrëfye për veprimitarinë tonë gjatë këtij mandati: lufta kundër diskriminimit ndaj shqiptarëve; zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqenies së popullit tonë; modernizimi i infrastrukturës në vendbanimet shqiptare; lidhja me shqiptarët në shtetet e tjera: vendkalimet e

Zgjedhja e Avokatit të Popullit rrezikon të kthehet në pikën zero

PRISHTINË, 20 GUSHT - Që nga 2 korriku i këtij viti Avokatit të Popullit, Hilmi Jasharit, i ka kaluar mandati. Megjithatë, ai do ta ushtrojë këtë funksion deri në zgjedhjen e pasuesit të tij. Procesi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit rifilloi në muajin mars, mirëpo kreditibiliteti i këtij procesi është vënë në pikëpyetje nga shoqëria civile që ka shprehur dyshime për manipulim.

Dilema për procesin kanë edhe deputetët që janë pjesë e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut. Ata shfaqën mospajtime sa i takon numrit të personave që ishin përgjedhur nga komisioni vlerësues për t'u dërguar për votim në Kuvendin e Kosovës. Paneli përgjedhës kishte rekanduar katër emra me arsyetimin se dy prej tyre kishin pikë të barabarta. Por, në këtë rast, pikë të barabarta kanë kandidat i parë dhe i dytë.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosjes, Salih Zyba, beson se kjo bie ndesh me rregulloret e punës së Kuvendit. "Kemi kundërshtuar që të shërbeshet seanca me katër emra. Për shkak që të mos vihet në lajthitje e të bëhet ndonjë shkelje procedurale, përfaktin se konsiderojmë se është shumë i nevojshëm një interpretim ligjor në këtë fazë", ka thënë Zyba.

Por, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" kryetarja e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Duda Balje, thotë se janë në pritje të interpretimit të Zyrës ligjore të Kuvendit përpëra se t'i dërgojnë emrat për votim në Kuvend.

Balje shpreh optimizëm se Avokati i ri i Popullit do të zgjidhet në fillim të muajit shtator, pasi aktualisht Kuvendi është në pushim. "Ne jemi duke pritur interpretimin ligjor nga Zyra Ligjore e Kuvendit sepse në komision nuk kemi gjetur

mënyra për bashkëpunim dhe unë tash kam dorëzuar një letër, përmes së cilës zyrtarisht jam duke kërkuar mendim nga Zyra Ligjore e Kuvendit. Tash jemi në fazën e pritjes. Ne jemi tani në pushim dhe unë mendoj se prej fillimit të muajit të ardhshëm do të votojmë për Avokatin e ri të Popullit", ka pohuar Balje. Në garë të ngushtë për pozitën e Avokatit të Popullit aktualisht janë katër emra, Edona Hajrullahu, që ka shërbyer si zëvendësavokate e Popullit mandatin e kaluar, Naim Qelaj, që ishte emëruar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj në postin e zëvendësministrit të Drejtësisë, Xhavit Shala dhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani.

Dyshime për manipulim të procesit

Për shkak të dyshimeve për manipulime në procesin e përgjedhjes së Avokatit të Popullit, shoqëria civile po kërkon kthimin e këtij procesi në pikën zero.

Grupi i organizatave të shoqërisë civile, që kanë monitoruar procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, konsideron se ka pasur mungesë transparence që nga intervistimi e deri në fazën e vlerësimit të kandidatëve përkëto garë.

Vullnet Bugaaku nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike në Kosovë thotë se procesi i intervistimit dhe vlerësimit ka qenë joprofesional. "Ka qenë një proces tërësishët ligjor, jotransparent dhe është përcjellë me vendime prapa dyerë të mbyllura. Ne i kemi njofuar edhe kryetaren e Kuvendit, edhe kryesinë, edhe Ambasadën e Britanisë, ku kemi kërkuar që ky proces të rivlerësohet, do të thotë të kthehet edhe një herë në pikën

zero, pra të ftohen edhe një herë të gjithë kandidatët", ka deklaruar Bugaaku.

Kundër këtij procesi të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit, përvèç Grupit për Studime Juridike dhe Politike, janë shprehur edhe Rrjeti i Grave të Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Institutit KIPRED. Organizatat e shoqërisë civile, përpos përsëritjes së konkursit, kanë kërkuar edhe përfshirjen e Ambasadës së Britanisë në Prishtinë e ku, sipas tyre, ekspertët britanikë do të jepnin një vlerësim objektiv për secilin kandidat.

Avokati "pa mandat"

Që nga 2 korriku i këtij viti Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka mbetur me ushtrues detyre. Hilmi Jashari, që mbajti këtë pozitë në pesë vjetët e fundit, ka mbetur pa mandat që nga kjo datë. Jashari mbetet ushtrues detyre deri në zgjedhjen e Avokatit të ri. Këtë ia ka mundësuar Kuvendi i Kosovës.

Me Ligjin për Avokatin e Popullit, procedura e përgjedhjes së Avokatit të Popullit duhet të fillojë gjashtë muaj para skadimit të mandatit.

Procesi i përgjedhjes së Avokatit të Popullit është shoqëruar me telashë edhe në të kaluarën. Para se Hilmi Jashari të zgjidhej në këtë pozitë, Kuvendi i Kosovës në vitin 2015 kishte dështuar që t'i votonte kandidatët që ishin dërguar për votim në seancë. Kështu që ishte përsëritur konkursi ku votat e nevojshme i kishte marrë Hilmi Jashari. Zgjedhja e Avokatit të Popullit bëhet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët votojnë për kandidatët që i rekomandon Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut.



Qalaj sheh nga afër aktivitetet e policisë, bën thirrje për kujdes në komunikacion

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka dalë të enjten në terren për ta parë nga afër implementimin e planeve dhe aktivitetave policore. Në periudhën janar-qershor të këtij viti në aksidente trafiku vdiqën 15 persona më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Policia ka apeluar te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që t'i respektojnë rregullat e trafikut rrugor dhe t'u përshtaten kushteve dhe rrethanave të trafikut me qëllim të evitimit të aksidenteve dhe rritjes së sigurisë në trafik

EPOKA ERE Faton DÉRAMKU

PRISHTINË, 20 GUSHT - Policia e Kosovës një prej objektivave parësore ka edhe ofrimin e sigurisë rrugore për pjesëmarrësit në trafik dhe parandalimin e aksidenteve, ku implementimin e planeve dhe aktivitetave policore nga afër e përcollit të enjten drejtori i

përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Departamentit për Operacione, Afrim Ahmeti dhe nënkolonel Jeton Rexhepi, drejtor i Divizionit të Komunikacionit Rrugor. Policia e Kosovës në vazhdimësi ka ndërmarrë aktivitete policore të kombinuara si projekte sensibilizuese me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit

dhe, po ashtu, veprime ndaj kryerësve të kundërvajtjeve në trafik. Duke iu referuar raportit të Dekadës së Sigurisë Rrugore, në periudhën janar-qershor të këtij viti në aksidente trafiku vdiqën 15 persona më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas zyrtarëve policorë, edhe këto aktivitete që janë duke u ndërmarrë nga njësítë e trafikut kanë për qëllim parandalimin e

kundërvajtjeve dhe aksidenteve në trafikun rrugor dhe, po ashtu, janë në përputhshmëri edhe me aktivitetet që janë duke u ndërmarrë në kuadër të planit operacional 'ROADPOL 2020' (European Roads Policing Network - Rrjeti Evropian i Policie Rrugore). Kjo situatë e sigurisë rrugore është tregues për punën që është bërë nga të gjithë, përfshirë

institucionet, shoferët, pjesëmarrësit e tjera në trafik, gjithnjë pa shmanjur edhe ndikimin që ka pasur legjislacioni në fushën e trafikut rrugor. Policia e Kosovës apelon te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që t'i respektojnë rregullat e trafikut rrugor dhe t'u përshtaten kushteve dhe rrethanave të trafikut me qëllim të evitimit të aksidenteve dhe rritjes së sigurisë në trafik.



Dumoshi: Dera e MKRS-së është përherë e hapur për komunitetin boshnjak

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka zhvilluar të enjten një takim me përfaqësues të komunitetit boshnjak, i kryesuar nga Rasim Demiri, përfaqësues i koalicionit "Vakat", njëherësh deputet në Kuvendin e Kosovës.

Qëllimi i takimit ishte mbështetja e MKRS-së për komunitetin boshnjak në Prizren dhe Dragash dhe për kërkesat dhe problemet që ballafaqohet ky komunitet në fushat që imbulon ministria, në anën tjetër.

Deputeti Demiri tha se shumë



vendbanime të komunitetit boshnjak të këtyre dy komunave kanë mungesë të theksuar të

infrastrukturës fizike kulturore dhe sportive. "Ka fshatra ku banon komuniteti boshnjak që

nuk ka shtëpi të kulturës e terrene sportive dhe kërkoi nga ministria Dumoshi që MKRS-ja ta mbështesë financimin e projekteve që bëjnë të mundur këtë gjë", ka thënë ai.

Deputeti Demiri konfirmoi se shoqëritë kulturore dhe të rinjtë e komunitetit boshnjak janë shumë aktivë dhe mbështetja që u ofrohet nga niveli lokal është e pamjaftueshme andaj kërkojnë nga niveli qendror një mbështetje më të madhe.

Ministrja Dumoshi tha se MKRS-ja ka nënshkruar disa memorandume me Komunën e Prizrenit të cilat ia mundësojnë

komunitetit boshnjak një mbështetje të MKRS-së. "Ministria e mbështet komunitetin boshnjak si një investim në projekte kapitale, por edhe nëpërmjet subvencioneve. Për kërkosat që keni përfshirat që të mbështeten më shumë, do t'i shikojmë mundësitë që për vitin e ardhshëm të planifikohet dhe të realizohet në gjë e këtillë. Dera e ministrisë është e hapur për komunitetin boshnjak", ka thënë ministria Dumoshi, duke premtuar që shumë shpejt do të vizitojë këtë komunitet në Prizren dhe Dragash.

Selatin Novosella dekorohet nga Thaçi me urdhrin 'Hasan Prishtina'

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar Selatin Novosellën me urdhrin "Hasan Prishtina" për kontributin dhënë për Kosovën. "Në 75-vjetorin e lindjes dhe 55-vjetorin e veprimtarisë politike atd-

hetare, veprimtarin e njohur Selatin Novosella e dekorova me urdhrin 'Hasan Prishtina'. Në këto pesë dekada Selatin Novosella ka dhënë kontribut të vazdueshëm pothuajse në të gjitha ngjarjet me rëndësi historike për Kosovën.

Republika e Kosovës dhe gjeneratat e ardhshme do t'u jenë mirënjoyëse përjetësish të gjithë atyre që kanë dhënë kontribut në rrugëtimin tonë të gjatë përliri dhe pavarsësi", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Rritet përsëri numri i vdekjeve nga Covid-19

13 të vdekur dhe 158 raste të reja me Covid-19 në Kosovë



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 13 raste të vdekjeve nga Covid-19, duke e çuar numrin e përgjithshëm të viktimateve në 438. Gjatë 24 orëve të fundit, IKShPK-ja ka treguar se janë shënuar edhe 158 raste të reja me Covid-19, kurse 245 pacientë janë shëruar nga ky virus

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur 13 persona dhe janë shënuar 158 raste të reja me Covid-19. Në njoftimin për media është bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 245 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 7 929 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 639", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 38 raste, komuna Gjilan 29 raste, komuna Gjakovë 13 raste, komuna Pejë 13 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Drenas 6 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Viti 6 raste, komuna Kamenicë 5 raste, komuna Dragash 4 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Obiliq 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat

SARS-CoV-2 dhe 438 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 245 pacientë

Deçan, Kaçanik, Mitrovicë, Podujevë, Shtime dhe Skenderaj.

Ambasada e ShBA-së dhuron donacion për ShSKUK-në

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se Zyra për Bashkëpunim dhe Mbrojtje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, përfaqësuar nga kolonel Rose dhe Majorja Olson, në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar në Prishtinë ka dhuruar donacionin e radhës me kontejnerë për mbeturinave spitalore dhe pajisje të tjera në funksion të menaxhimit të Covid-19. "Vlera e donacionit është 103 000 euro dhe përmban: kosha të mbeturinave spitalore me pedale, kosha të mbeturinave spitalore

për mbeturina të kontaminuara të rrezikshme, kosha të për mbeturina të rrezikshme, koshat për mbeturina infektive (të rrezikshme), mbajtës/karrocë të mbeturinave metalike për materiale të rrezikshme, kontejner mobil të mbrojtur dhe me pedale për mbeturina radioaktive, kontejner të mbeturinave me mbrojtës dhe me pedale, mbrojtës shiringash - transportues për transport të sigurt të shiringave të disponueshme", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Sipas tij, menaxhimi i mbeturinave spitalore në mënyrë adekuat parandalon përhapjen e mëtejme të infeksioneve brenë dhe jashtëspitalore, përfshirë edhe infeksionin Covid-19. "Ky kontribut është vazhdimësi e përkujdesit që Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes misioneve të

veta civile dhe ushtarake i kanë ofruar në vazhdimësi sistemit tonë shëndetësor. Në emër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe qytetarëve të Kosovës shpreha falënderimet për përkrahjen e vazhduar gjatë menaxhimit të pandemisë Covid-19", ka shkruar Zemaj.

Licencohen edhe 18 laboratorë privatë për kryerjen e testeve për Covid

Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka licencuar të enjten edhe 18 laboratorë privatë për kryerjen e testeve për Covid-19. Kjo është bërë me dije me anë të një komunikate për media nga MSH-ja, ku edhe janë bërë me dije se cilët laboratorë kanë marrë dritën e gjelbër për kryerjen e testeve. Të njëjtë janë licencuar vetëm për kryerjen e testeve serologjike, dhe jo PCR. Kjo është lista e gjashtë me laboratorë privatë që licencohen nga Ministria e Shëndetësisë. Të gjithë këta laboratorë do të janë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për dallaveret dhe kurdisjet e mundshme në çmime.



Inspektorati anulon vendimin për shkarkimin e Basri Sejdiut nga pozita e drejtorit e ShSKUK-së

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Inspektorati i Punës e ka vlerësuar të padrejtë shkarkimin e Basri Sejdiut nga pozita e drejtorit e ShSKUK-së. Këtë e ka bërë me dije vetë Sejdiu, duke publikuar vendimin që ka pranuar nga Inspektorati i Punës. "Ky vendim konfirmon punën time të ndershme dhe

profesionale në ShSKUK, të cilën e mora në menaxhim në vitin 2017, në gjendje të rendë, gati të pashpresë. Gjatë mandatit tim kamë arritur t'i rris shërbimet në çdo klinikë të QKUK-së si dhe në spitale të përgjithshme duke pasur gjithmonë pacientin në qendër. Vlen ta potencojoë menaxhimin e suksesshëm të

pacientëve me Covid-19. Të përkujtojë se kemi pasur numrin më të vogël të fatalitetit nga kjo sëmundje në rajon, kemi mbrojtur stafin nga infeksioni dhe kemi krijuar hapësira të reja për menaxhim të kësaj sëmundje", ka njoftuar Sejdiu nëpërmjet llogarisë se vet në "Facebook" Sejdiu.

Zyra Kombëtare e Auditimit përfundon me sukses të gjitha auditimet për pasqyrat financiare vjetore 2019

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - “Auditimi i fondeve publike këtë vit ka qenë sfidues për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19. Balancimi i nevojave për ruajtjen e shëndetit të auditorëve dhe paralelisht zbatimi i mandatit duke siguruar cilësinë e punës sonë ka shkaktuar vonesa në disa raporte individuale të auditimit, por kemi kënaqësinë që, pavarësisht prej kushteve të rënda të punës, të konfirmojmë se Zyra Kombëtare e Auditimit ka përfunduar reportin vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të buxhetit të Republikës të Kosovës për vitin 2019 dhe kështu është përmbyllur me sukses të plotë viti i auditimit”, është thënë në komunikatën e ZKA-së. Sipas ZKA-së, përveç performancës financiare të qeverisë, raportet e këtij institucioni kanë ofruar informata shtesë edhe për fushat të tjera që kanë të bëjnë

me afarizmin e ndërmarrjeve publike, performancën e shpenzimeve të fondeve publike (ekonomizimi, efektiviteti dhe efikasiteti), si dhe zbatimin e procesit të prokurimit e raportimit financiar. “Gjatë vitit reportues kemi audituar 95 organizata buxhetore me një buxhet të përgjithshëm rreth 2.5 miliardë, 14 ndërmarrje publike kryesisht në fushën e telekomunikimit, furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave, 13 auditime të performancës si dhe 9 projekte të finansuara nga fondet e donatorëve. Me rastin e përfundimit të vitit auditues, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka theksuar se fokusi parësor i punës së tyre kanë qenë vlerësimet për cilësinë e raportimit financiar, dizajnimin dhe efektivitetin e sistemave të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me



ligjet dhe rregulloret në fuqi”, është bërë me dije në komunikatën e ZKA-së.

ZKA ka theksuar se përmes procesit të auditimit ka konstatuar se ka një përparim të lehtë në fushën e raportimit financiar, por mangësitë dhe dobësitë më të theksuara vazhdojnë të mbeten në aktivitetet ekzekutive të

buxhetit ku shumë projekte kapitale fillohen pa fonde të mjaftueshme dhe për shkak të kësaj, ato rrallëherë përfundohen me kohë, ndërkohë që mbikëqyrja nuk parandon devijimet e shumta nga kushtet e përcaktuara me kontrata. “Me këtë rast në mënyrë të veçantë është kërkuar nga qeveria që ta forcojë

disiplinën financiare sepse shumat e detyrimeve të papaguara dhe llogarive të arkëtueshme kanë arritur shifra të larta dhe, padyshim, janë sfidat kryesore të qeverisë derisa regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive paraqesin një problem të përsëritur prej shumë vitesh dhe përparimi në këtë fushë është i varfër. Me rastin e përfundimit të vitit auditues falënderojmë organizatat e audituara për bashkëpunimin korrekt në këto kushte të pandemisë derisa vlerësojmë me notat më të larta personelin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm përmbyllen me sukses planin e punës”, thuhet në këtë komunikatë. Zyra Kombëtare e Auditimit më 15 shtator fillon vitin e ri të auditimit dhe aktualisht në mënyrë intensive po punohet në planin vjetor të punës 2020/2021.

Ministria e Bujqësisë zgjat deri më 28 gusht afatin e aplikimit për grante



PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka zgjatur deri më 28 gusht 2020 afatin për aplikim për

grante në kuadër të masave mbështetëse të Programit të Zhvillimit Rural të këtij viti. “Kjo zgjatje e periudhës për aplikim po bëhet për shkak të

situatës së krijuar në vend nga pandemia Covid-19, duke iu mundësuar në këtë mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve dhe agrobizneseve.

Procedurat e aplikimit dhe dokumentacioni mbetet i njëjtë”, është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural. Ndryshtë, afati për aplikim për grante investive ishte paraparë të mbollej më 20 gusht 2020.

Hoti: Në shtator fillon zbatimi i planit pesëvjeçar për rimëkëmbjen ekonomike

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në takimin që kishte me Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ka thënë se qeveria në muajin shtator do ta fillojë zbatimin e planit pesëvjeçar të rimëkëmbjes ekonomike. Ai ka treguar se vlera e këtij plani do të jetë 6 miliardë euro

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka kryesuar takimin e parë të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ku janë diskutuar hapat për harmonizimin e veprimeve të institucioneve shtetërore me sektorin privat dhe me partnerët e tjerë zhvillimorë që janë të përfshirë dhe që ndihmojnë në promovimin e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. "Përmes këtij Këshilli unë besoj se do ta vazhdojmë punën e mirë që është bërë edhe në të kaluarën, në mënyrë që t'i harmonizojmë veprimet e institucioneve shtetërore me sektorin privat dhe me partnerët e tjerë zhvillimorë që janë të përfshirë dhe që ndihmojnë në promovimin e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo është tepër e rëndësishme, kur ne po përballemi tash me pasojet sociale dhe ekonomike të pandemisë", ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se qeveria ka formuar Fondin për Rimëkëmbje Ekonomike prej 365 milionë eurosh dhe në vendimin e qeverisë të para një javë ka shpërndarë këtë fond nëpër masa të ndryshme. "Tash, në periudha afatshkurta, që nënkupton menjëherë në javët

dhe muajt e ardhshëm, duhet të punojmë bashkë me ju që të zbatojmë në praktikë, të implementojmë këtë pako të rimëkëmbjes ekonomike përmes masave të ndryshme. Siç e keni parë në vendimin e qeverisë, në aneks-tabelën ku janë të përshkruara të gjitha vendimet, është i ndarë edhe roli i të gjitha institucioneve publike, por edhe i partnerëve zhvillimore dhe i odave ekonomike", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se ministrat përkatës janë duke i bërë përgatitjet e nevojshme që nënkupton nxjerrjen e udhëzimeve, dokumenteve ose kritereve në bazë të cilave i shpërndajnë fondet për subvencionim të pagave ose për mbulim të normës së interesit, ose për subvencione të ndryshme, ndihmë të ndryshme në sektorë të ndryshëm. "Ju do të jeni të përfshirë edhe në përgatitjen e kritereve për shpërndarjen e këtyre fondeve, edhe në komisionet vlerësuese për shpërndarjen e atyre fondeve, sepse ne dëshirojmë të sigurohemi që duke qenë se janë para publike të shpërndahen në transparencë të plotë por, mbi të gjitha, të shkojnë në vendin te kompanitë, në ndërmarrjet, të punëtorët ku jepin efektin maksimal dhe askush më mirë sesa ju nuk i di nevojat e ekonomisë dhe nevojat e

bizneseve", është shprehur ai. Kryeministri Hoti ka theksuar se ashtu kanë pasur në plan që në shtator ta fillojnë draftimin e strategjisë së re zhvillimore për Kosovën. "Tash jemi të nxitur dhe të shtyrë nga nevojat që kemi për të ofruar një plan afatgjatë të rimëkëmbjes ekonomike, sepse është më se e qartë që ne do të përballemi me probleme të rimëkëmbjes ekonomike jo vetëm brenda këtij viti, por jam i sigurt komplet gjatë vitit të arrijmë e, ndoshta, përtet saj, sepse kohëzgjatja e kësaj pandemie nuk është se ka krijuar disa vështirësi afatshkurtra të likuiditetit të bizneseve, por është e qartë që ka shkaktuar shkundje, trandje afatgjatë të ekonomisë dhe të bizneseve nëpër sektorë të caktuar dhe ne tash duhet të kemi një qasje pak më afatgjatë. Çka nënkupton kjo për ne? Nënkupton një zhvillimore strategji

pesëvjeçare e cila neve na mundëson që ta mobilizojmë siç kemi mobilizuar këto fonde nga buxheti dhe nga kreditë që kemi marrë deri më tash 365 milionë euro, deri në fund të vitit 2021 të arrijmë ta rrumbullakojmë atë pakon afatshkurtër të rimëkëmbjes që shkon në 1.2 miliard, por të fokusohemi me një plan së paku pesëvjeçar që shkon deri në 6 miliardë euro ndihmë për ekonominë, që përfshinë edhe ndihmën e drejtëpërdrejtë nga buxheti edhe përmes kredive shtetërore, edhe përmes garancioneve kreditore që duhet të lëshojë qeveria për investimet private, edhe mobilizim i mjeteve të donatorëve e këtu në rend të parë nënkuptoj mjetet e Komisionit Evropian që janë bukur të mëdha për të cilat veç jemi në procedurë", ka deklaruar Hoti, duke shtuar se në javën e parë të tetorit do ta

kenë Konferencën e Donatorëve për Ballkanin Perëndimor, ku do të vendosen përfundimisht projektet e mëdha infrastrukturore të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, disa prej projekteve që i lidhin më mirë këto vende, projekte infrastrukturore kryesisht, por që krijojnë efekte multiplikuese në ekonomi, që shkojnë për Kosovën besoj deri në 700 milionë euro në periudha pesëvjeçare. "Janë fondet e MCC-së për të cilat jemi duke i finalizuar në konsultim me tri ministritë e linjës projektet që do të financohen nga MCC në vitet në vijim dhe nga donatorë të tjerë. Unë jam konfident që gjatë muajve shtator-tetor do të arrijmë ta rrumbullakojmë çështjen e strategjisë pesëvjeçare për ta mobilizuar shumën prej 6 miliardë eurosh në mbështetje të sektorit privat", ka thënë Hoti.



Ministri Krasniqi i njofton bizneset me planin e qeverisë për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 20 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministra e Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj, bashkë me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, kanë vizituar disa fabrika në Prizren. Dy zyrtarët qeveritarë janë ndarë të kënaqur se si po funksionojnë këto biznese, pavarësisht prej

situatës pandemike në vend. Ministri Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se në të gjitha këto takime përfaqësuesit e këtyre bizneseve i ka njoftuar për masat që ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës në planin për rimëkëmbje ekonomike. "Me këtë plan rreth 70 përfi-


tojnë mbështetje e cila kon siderohet se do t'u ndihmojë që bizneset ta vazhdojnë funksionimin. Bizneset shprehën edhe brengat dhe problemet me të cilat po ballafaqohen. Shpreha gatishmërinë dhe vullnetin që kërkosat e tyre të trajtohen me përkushtim", ka shkruar Krasniqi.

Së shpejti i gatshëm për vizitorë Parku i Pishave në vargmalet e Zhegovcit

FERIZAJ, 20 GUSHT (ER) - Atraksioni turistik i vargmaleve të Zhegovcit, përkatësisht pjesës që shtrihet në fshatrat Mirosalë dhe Rahovicë me largësi 10 kilometra nga Ferizaj, së shpejti do të jetë i gatshëm për vizitorët dhe pasionantët e natyrës. "Është investim i Komunës së Ferizajt, përkatësisht vizion i qeverisë Aliu, që ta kthejë këtë zonë në

një atraksion turistik dhe pikë referencë të re të pasurisë sonë natyrore. Tashmë shtigjet për ecjen janë pothuajse në përfundim dhe, gjithashtu, edhe infrastruktura tjetër e nevojshme", kështu ka thënë drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyqi, dikasteri i cili është bartës i këtij investimi.

Drejtori Bytyqi ka thënë se me këtë investim po i jepet një pamje e re kësaj zone, duke rritur kështu edhe mundësitë e zhvillimit rural për fshatrat e kësaj ane. Ai ka shtuar se jo vetëm me këtë investim, por edhe me investimet e tjera që priten të ndodhin në pika të ndryshme turistike në Ferizaj, përfundimisht kompletohet mozaiku i investimeve bazë në infrastrukturën turistike.



Bëhet zbulimi i shtatores së heroit Ismet Ukaj

DEÇAN, 20 GUSHT (ER) - Të enjten në Strelc të Epërm të Deçanit është bërë zbulimi i shtatores së heroit të kombit, Ismet Ukaj. Në zbulimin e kësaj shtatore ishin të pranishëm ish-kryeministri Ramush

Haradinaj, kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, përfaqësues të Kuvendit Komunal të Deçanit, bashkëveprimtarë të Ismet Ukajt dhe familjarë.

Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se familja e

heroit Ismet Ukaj na dëshmoi edhe sot për vlerën, heroizmin dhe patriotizmin që ka sepse, sipas tij, në këtë ditë ata falën gjakun e vëllait të tyre, e që është veprë më shqiptare që mund të bëhet.

projektet kapitale të këtij viti. Me këtë rast, Komuna e Prizrenit ka njoftuar të gjithë qytetarët që vazhdon thirrja për pranim të kërkësave dhe sugjerimeve për projektet kapitale që do të realizohen në vitin 2021.



Haziri dhe Likaj konfirmojnë përgatitjet për fillimin e rregullt të mësimit

GJILAN, 20 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune ministrin e Arsimit, Shkencës, Ramë Likaj, ku temë kryesore e takimit ishte përgatitja për fillimin e vitit të ri shkollor. Në takim u konfirmua se po punohet maksimalisht që mësimi të fillojë i rregullt, me praninë fizike të nxënësve dhe mësimdhënësve nëpër shkolla, i planifikuar mirë përmes tre skenarëve me specifika të ndryshme jo vetëm për komuna të caktuara, por edhe për shkolla.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në fjalën e tij ka falënderuar ministrin Ramë Likaj dhe kryetaren e Komisionit

Parlamentar për Arsimit, Valentina Bunjaku-Rexhepi përvizitën, duke i njoftuar për të gjitha përgatitjet që deri më tanë i kanë bërë Komuna e Gjilanit dhe Task-forca për Arsimit. "E kam njoftuar ministrin Likaj përtë gjitha përgatitjet që i ka bërë Komuna e Gjilanit me Drejtoren e Arsimit, gjithashtu edhe përsfidat që do të na presin brenda këtij viti shkollor, infrastrukturën shkollore, mësimin profesional dhe çështje të tjera që janë në interes të zhvillimit të arsimit si prioritet kryesor në Komunën e Gjilanit", ka thënë kryetari Haziri.

Ndërsa ministri Ramë Likaj ka potencuar se janë të vendosur



që mësimi të fillojë normalisht, duke i zbatuar të gjitha kriteret e parapara në manualin e

përgatitjet institucionale në fillimin e vitit shkollor në kushtet pandemie. Presim së shpejti publikimin e vendimit dhe datën kur do të fillojë mësimi. Në këto kushtet pandemie jemi shumë të kënaqur me përgatitjet për fillimin e mësimit. Gjithashtu, kemi biseduar edhe për angazhimin e mësimdhënësve rezervë dhe studentëve të Fakultetit të Edukimit në procesin mësimor. Kemi tre skenarë, të cilët janë në funksion në bazë të gjendjes me pandeminë. I fundit është ai për mësimin në distancë, por do të punohet që mësimi të mbahet në shkolla me masa mbrojtëse dhe kujdes maksimal", ka thënë ministri Likaj.

UÇK-JA KA QENË UNIKE DHE ME NJË DISIPLINË TË NDËRGJEGJSHME (32)



Shkruan: Kudusi LAMA

Në këtë raport i është dhënë një informacion i gjenjeshtërt Këshillit të Evropës, duke krijuar një opinion shumë dyshues për Luftën Çlirimtare të Kosovës si dhe për pjesën e spektrit politik që vjen nga lufta në Kosovë e gjithë spektrin politik në Shqipëri. Një opinion që realisht Kosovës dhe shqiptarëve në tërsësi do t'u kushtojë shumë, pasi nuk është e lehtë të përmbyshë një opinion që krijohet me pjesëmarrjen e organizatave madhore ndërkombëtare, siç është Këshilli i Evropës, pavarësisht prej përgjegjshmërisë, apo papërgjegjshmërisë së autorit të raportit, përkatësisht zotëri Dick Martyt.

Duke e studuar për çdo pikë raportin vërejmë dhe vlerësojmë: Që në pikën 1 duket joserioziteti i këtij rapporti, kur tregon se mbështetet në kujtimet e Karla Del Pontes, e cila, për çudi, megjithëse ishte kryeprokurore e gjykatës së ngritur për krimet lufte, ishte ajo që solli në bankën e të akuzuarit Sllobodan Milosheviqin, mori të akuzuar dy liderë të UÇK-së, siç ishin Ramush Haradinaj prej detyrës së kryeministrit të Kosovës dhe Fatmir Limjan prej sferave të larta të politikës dhe nuk paska pasur fuqi të marrë të pandehur të tjerë në nivele shumë më të ulëta se kryeministri i Kosovës, siç është kryeministri aktual Hashim Thaçi, i cili akuzohet në këtë raport, që në atë periudhë ishte në politikë, por pa pushtetin qeverisës, pa folur për figura të tjera nën akuzë kujtimesh që as në atë kohë as edhe solli nuk kanë qenë as nuk janë aq të frikshëm sa të trembojn Karla Del Ponten, që ishte me vete gjithë fuqinë botërore, për të bërë çfarë të vlerësonë se duhej bërë. Pra, kjo duket vërtet një shaka, por që askush nuk e mori me shaka.

Sipas kujtimeve që kanë shkruar gjatë historisë njerëz të ndryshëm, duke akuzuar të tjerë që kanë dëshiruar t'i akuzojnë, do të kishim mbetur duke varur njerëz dhe pakkush prej atyre që kanë vepruar në këtë botë do të ishte mbi kujtimeve që kanë këtë variant tjetër kriminaliteti, pasi të jetë larguar nga funksionet politike ndërkombëtare. Nuk përashtohet mundësia, duhet të jemi të përgatitur për t'u ndeshur edhe me ndonjë variant të tillë. Shikojini si i prezanton shqiptarët zotëri Marty në Këshillin e Evropës nëpërmjet pikës 3 të raportit të tij. Ai duke pretenduar se ishte gabuar që në

Ponte në detyrën e lartë që ushtronë në emër të OKB-së, që nuk pati guxmin t'i publikojë faktet kur ishte në detyrë, por vetëm për t'i dhënë si kujtime pas largimit nga detyra?

Të gjithë duhet të jenë të sigurt që ajo nuk i është trembur asku. Por ajo ka qenë e zgjuar dhe e ka ditur përfundimin dështues, nëse do të kishte ngritur akuzë. Kështu që duke dhënë versionin në formën e kujtimeve, ajo e realizoj qëllimin e saj për të hedhur baltë mbi shqiptarët, sipas misionit pse jo që ka pasur prej Serbisë, sipas ndonjë marrëveshjeje të hershme, që me arrestimin e Sllobodan Milosheviqit. Ashtu sikurse shkruhet në pikën 1 të raportit "gati dhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, flitet për një trafikim organesh njerëzore që u janë marrë robërvë serbë, trafikim i cili, siç thuhet në libër, ishte i organizuar nga drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)". Dhe siç merret me mend: "Këto pretendime ishin tronditëse dhe ngjallën reagime të ashpra". Pasi edhe përpunimi i opinionit nëpërmjet mediave, u bë në mënyrë shumë të organizuar dhe dinamike.

Aq i fuqishëm ka qenë ndikimi i këtyre kujtimeve, sa që menjëherë bëhet një rezolutë (Dok. 11574) dhe caktohet një raportues, detyrë e cila i ngarkohet zotëri Martyt. Kështu deklarohet në pikën 2 të këtij rapporti, prej të cilës lindin pyetje të thjeshta por shumë domethënëse: Si ka mundësi që ndërmerren veprime me kaq urgjencë për këto imaginata, kur për dhjetë vjet nuk kishin shqetësuar kryeprokuroren e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet Lufte në Jugosllavi, sa të ushtronë të drejtë e saj ligjore? Si ka mundësi që edhe pas vrasjes së disa qindra mijëra njerëzish dhe bërrës së katër luftrave mezi u morë vendimi për ta shpallur të dyshuar për krimet lufte Sllobodan Milosheviqin, ndërsa nëpërmjet disa kujtimeve menjëherë shpallet e kriminalizuar një luftë çlirimtare, siç ishte Lufta Çlirimtare e Kosovës? Nuk e di a do të mundet Zotëri Marty ndonjëherë të jetë aq i drejtë, sa ta rishikojë vërveten e të nxjerrë konkluzione. Apo ndoshta edhe ky zotëri po përgatit kujtimet, për të na nxjerrë ndonjë variant tjetër kriminaliteti, pasi të jetë larguar nga funksionet politike ndërkombëtare.

Nuk përashtohet mundësia, duhet të jemi të përgatitur për t'u ndeshur edhe me ndonjë variant të tillë. Shikojini si i prezanton shqiptarët zotëri Marty në Këshillin e Evropës nëpërmjet pikës 3 të raportit të tij. Ai duke pretenduar se ishte gabuar që në

veprimtarinë e deritanishme "... njëra palë ishte viktimat, dhe pala tjetër, xhelatët", që realisht të gjithë shqiptarët e dinë se realisht kështu ka qenë, që Serbia nuk ka qenë tjetër veçse xhelati i shqiptarëve që i ka shuar në vazhdimësi për 100 vjet, kërkon që kjo viktimë që ishte populli shqiptar në trevat e pushtuara, të trajtohet ndryshe. Por që ishte e vështirë të arrihej sukses sepse, siç na etiketon zotëri Marty:

"Struktura ende tepër klanore e shoqërisë kosovare shqiptare, si dhe mungesa e një shoqërie të vërtetë civile e bënë jashtëzakonisht të vështirë vendosjen e kontaktave me burimet lokale". Pra shqiptarët sipas tij akoma nuk janë një komb, por janë fise ose klane dhe se ndër ta mungon civilizimi shoqëror. Kështu ky zotëri bëhet ndër të rrallët evropian, që ka shkelur tokën shqiptare, që nga shekulli i 18-të, dhe që ka gjetur vetëm klane fisnore dhe mungesë civilizimi, sepse në përgjithësi evropianët që kanë ecur nëpër tokën shqiptare prej shekullit 18-të e deri sotkanë deklaruar se në këto treva jeton një popull fisnik, paqësor, besnik, mikpritës dhe shumë i kulturuar. Çfarë e bën të civilizuar një komb përtej këtyre?

Megjithatë në këtë pikë tërheqin vëmendjen terma të tilla si "frikë" e "tmerr", për ta justifikuar dështimin në marjen e asaj që ka dëshiruar, prej individëve që nuk kanë pasur t'i thonë zotërisë atë që ai donte t'i thuhej. Ndërsa: "Sa për autoritetet shqiptare, ato bënë të ditur se territori i tyre ka qenë jashtë konfliktit dhe nuk kishin asnjë arsyë për fillimin e një hetimi". Është e vërtetë që Shqipëria ka qenë ligjërisht jashtë konfliktit, por nuk kam dëgjuar se shteti shqiptar në ndonjë moment u është bërë pengesë, përvëç, nëse nuk u ka lënë që të improvizoni "fakte" siç keni dëshiruar ju. Po pse zotëri Marty, ju nuk merreni edhe me ato mbi 12 mijë predhat e ushtrisë serbe, që kanë rënë brenda kufirit të shtetit shqiptar e kanë vrarë mbi dhjetë qytetar të këtij shteti në shtëpitë ose në pronat e tyre? Apo edhe ata nuk janë viktima, edhe ata duhet të iknin nga vendi i tyre.

Njëkohësisht ju tregoheni i padrejtë edhe me specialistët ndërkombëtar që kanë vepruar për këto çështje para jush, duke u shprehur se edhe ata nuk kanë arritur asgjë "duke vepruar megjithatë në një mënyrë mjaft sipërfaqësore dhe me një shkallë profesionalizmi që njall njëfarë habie". I vetmi profesionist për zbulimin e krimeve, që siç duket paska bota, qenka vetëm zotëri Marty, mjerë bota kur të mos jetë më.

Ndërkohë, ju deklaroni se Gjykata për krimet lufte në Hagë

paska pasur mandat vetëm deri në qershor 1999, pse pra ju jeni futur në hapësirën e përgjegjësive të saj? Apo ndoshta përfaktin se ajo nuk e ka bërë mirë punën e saj.

Në pikën 4, shpreheni se prej verës së vitit 1999 në këtë rajon, (që nuk e di ku i ka hapësirat, por të lë të kuptohet se me termin rajone, keni parashysh të gjitha trevat ku banojnë shqiptarët), mbretëronte një pështjellim i madh se forcat serbe të sigurisë kishin braktisur Kosovën. Së pari duhet të dini se ata nuk e braktisën Kosovën por u hodhën jashtë prej atyre që ju sot po tentoni t'i quani kriminelë. Së dyti, të bënë ju njënjë raporte të tilla nuk do të kthehen dot më kurrë. Së terti, shqiptarët kurrë nuk kanë qenë të siguruar prej serbëve, por vetëm të masakruar prej tyre. Së katërti, në këto treva gjendje pështjellimi ka sunduar sa ishin serbët të pranishëm, se pas ikjes së tyre, shqiptarët e kanë pasur vizionin shumë të quartë se do të janë përfjetësish të lirë në këto treva dhe janë angazhuar për të bërë shtetin sa më të fortë e vital, sipas standardeve moderne bashkëkohore. Së pesti, trupat e KFOR-it në Kosovë nuk kanë ardhur të shtypin këtë popull, siç e ka shtypur Serbia më parë, por kanë ardhur, t'i japin Kosovës siguri pikërisht prej Serbisë, që është e pa përgjegjshme si qytetare europiane. Së gjashti, ju nuk keni dëshirë të pranoni që në atë periudhë që ju e quani "kaosi", (që realisht nuk keni të drejtë se nuk ka qenë kështu), në Kosovë kishte marrë drejtimin Qeveria e Përkohshme e Kosovës, e cila kishte vendosur bashkë me luftëtarët e UÇK-së dhe popullin e Kosovës që u kthye menjëherë në shtëpi (prej nga e kishin përzënë ushtria dhe policia e Serbisë), ishin mobilizuar për të vendosur normalitetin e pasluftës. Së shtati, në qoftëse nuk e dini goditjet e NATO-s kanë filluar me 24 mars 1999, jo në verë, pasi duket se qëllimisht i ngatërron datat, mos bëj gabime të tilla, që realisht prej funksionit ku jeni ju bëjnë faktor, që nëse ka drejtësi, një ditë duhet të përgjigjeni para ligjit për shpërdorim detyre.

Dua t'i them në këtë rast, se ju duke deklaruar pa dashje ose me qëllim keqdashës se "aleati faktik i NATO-s ishte UÇK-ja", sillni një të vërtetë, që edhe sikur të jetë fakt rëndues, unë si një njeri që ka qenë aty, në atë kohë, e pranoj se është plotësish e vërtetë. Nëse ta kundërshton dikush, për këtë të dal edhe unë dëshmitarë.

Në vazhdim ju thoni: "Kësosoj, në periudhën kritike që sapo përshkruam, kjo e fundit kishte, kontrollin faktik mbi një territor të gjerë që përfshinte Kosovën dhe rajonet kufitare të Shqipërisë

veriore". Nuk e di pse e quani periudhë kritike, pasi realisht për të gjithë shqiptarët ka qenë periudha më e përsosur e lumturisë pasi ata për herë të parë pas 100 vjetësh po e shikonin veten pa pushtues. Dhe nuk është e vërtetë që ka pasur pushtet brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, shteti shqiptar ishte plotësish funksional, bashkëpunëtorë i NATO-s dhe nuk kishte asnjë pëllimbë tokë jashtë kontrollit. Pavarësisht se e kuptoj, se ju nuk e keni këtë vlerësim në sensin pozitiv për vlerat e UÇK-së, por ja që realisht ajo i kishte vlerat superiore për çlirimin e vendit dhe vendosjen e stabilitetit pas lufte, kur kishte një vend të shkretuar nga pushtuesi serb dhe 75% (për qind) të popullit të Kosovës të shpërndalur. Por duke folur për këtë çështje, unë bie dakord me shprehjen tuaj se realisht në atë periudhë të pasluftës "nuk bëhej fjalë për një poshtet me të vërtetë të strukturuar dhe as që bëhej fjalë se mund të kishte konturet e një shteti", por nuk kuptoj fjalë pasardhëse "përkundrazi" çfarë kuptimi ka. Çfarë doni të thoni me këtë fjalë? Fjalëve të tilla të futura nëpër raport, ne shqiptarët u themi "me i futë mish dhie", kur dikush e bën bisedën me hile, siç e bënë raportin ju zotëri Marty. Atë "përkundrazi", fute në xhep zotëri, se tek ne nuk ka vend, megjithëse ju gjithë fjalinë e keni formuluar vetëm që të thoni në fund atë fjalë kyç vlerësuese përgjithësitë situatën e kohës. Dhe ju pikërisht këtë periudhë, që nuk e di ku fillon e ku mbaron, se vërtetë nuk e keni përcaktuar, e quani si periudhë të artë kur "u kryen krimë të shumta" Jo zotëri, shqiptarët nuk i bëjnë punët e mëdha fshehurazi, por publikisht. Shqiptarët serbët i kanë luftuar sa e mori vesh gjithë bota dhe bota moderne u bë bashkëluftëtare e tyre, siç e deklaroni edhe ju. Ashtu edhe shqiptarët bashkëpunëtor të armikut shqiptarët i kanë luftuar sa e mori vesh gjithë bota dhe bota moderne u bë bashkëluftëtare e tyre, siç e deklaroni edhe ju. Ashtu edhe shqiptarët bashkëpunëtor të armikut shqiptarët i kanë luftuar në vijat e fronteve të luftës. Por popullin e thjeshtë, qofshin serb ashtu edhe shqiptarët, luftëtarët e lirisë nuk e kanë dëmtuar edhe kur luftohej e u vritesin shokët nëpër vijat e fronteve, jo ta dëmtonin me gjaktohtësi pas lufte siç pretendoni ju. Ndërsa edhe njëherë duhet t'iu rikujtoj se në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nuk ka pasur fraksione, ajo ka qenë unike dhe me një disciplinë të ndërgjegjshme që nuk di a gjendet në ndonjë ushtri tjetër vullnetare siç ishte UÇK-ja. Prandaj mos na e shpikni këtë çështjen e "rivalitetëve midis fraksioneve të UÇK-së", se populli shqiptar e di mirë që ka pasur vetëm një UÇK, nën një flamur e nën një uniformë. (Vijon)

Shën Korona: Shenjtorja kryesore mbrojtëse nga epidemitë?

Shën Korona, është një nga shenjtoret më pak të njohura të Krishtërimit. Dhe ndoshta do të vazhdonte të ishte kështu, po të mos ishte shfaqur pandemia e koronavirusit, që e risolli në vëmendjen e njerëzve këtë shenjtore të harruar nga shumica.



Ndërsa njerëzimi po përballet me një sëmundjeje të re të tmerrshme, disa njerëz i kanë varur shpresat e tyre tek shkencëtarët për një shpikje apo për një zgjidhje mjeqësore që do të frenonte sëmundjen, ndërsa të tjerët luten për një ndërhyrje hyjnore, dhe kanë në fokusin e lutjeve të tyre Shejtoren Shën Korona, për të kryer një mrekulli.

Sidoqoftë, për shumëkënd Shën Korona mbetet një figurë enigmatike, me shumicën që refuzon të besojnë se dikur ka ekzistuar vërtet një shenjtore mbrojtëse ndaj epidemive, aq më tepër me një emër kaq të ngjashëm me pandeminë shkatërruese të koronavirusit, që po terrorizon prej muajsh mbarë botën.

Gjithsesi, ndonjëherë një pyetjeje nuk mund t'i jepet vetëm një përgjigje e prerë po ose jo. Ajo duhet të kuptohet vetëm duke shqyrtuar nga afër historinë që prodhoi faktet, e cila duket më shumë si një histori legjendare sesa reale. Biografia e Shën Koronës merret me faktet që supozohet se kanë ndodhur afro 1850 vjet para pandemisë aktuale të koronavirusit.

Historia e Shën Koronës, fillon diku në gjysmën e dytë të shekullit II te Erës Sonë, kur Krishterimi nuk ishte ende një fe dominuese, dhe kur të krishterët përballesin me persekuime të shpeshta nën perandorisë romake, vetëm pse kishin një besim që nuk njihej nga udhëheqësit e feve kryesore të kohës.

Perandoria Romake nën drejtimin

e perandorit Mark Aurel ishte relativist e qëndrueshme, dhe vetë perandori konsiderohet nga shumë studiues si perandori i fundit i 'Pax Romana', "Paqes Romake", dhe nënkuption paqen dhe prosperitetin relativ të kohës. Megjithatë, paqja nuk është kurrë një dukuri absolute.

Në periudha të tilla, midis shumë tregimeve që lanë gjurmë në historinë e kohës, një nga rrëfimet që bie në sy është ai mbi Shën Viktorin dhe Shën Koronën. Ngjarjet ndodhin në Siri në vitin 170 pas Krishtit. Në atë kohë, Shën Viktori ishte një ushtar romak (me prejardhje italiane), por që praktikonte Krishterimin në fshehtësi.

Një ditë u kap nga romakët e tjerë, dhe u nxor para gjyqit pse ndiqte doktrina fetare që ishin rreptësish të ndaluara nga Perandoria Romake. Në atë kohë, drejtësia romake nuk tregonte aspak mëshirë përfajtorët, sidomos për ata që ndiqnin Krishterimin.

Fati i Viktorit u vulos që kur nxor para një gjykatisë të quajtur Sebastian, që shquhej për urrejtjen dhe përcëmin e tij të madh ndaj të krishterëve. Sebastiani vendosi t'i japë një dënim që të shërbente si shembull për të gjithë ata që do të guxonin të kundërshtonin Perandorinë Romake.

Sebastiani vendosi ta ndëshkojë Viktorin në një shesh publik. Ai u lidh pas një shtyllë dhe u rrah derisa lëkura nisi t'i varej nga trupi. Sebastiani mizor urdhëroi pastaj që Viktori të verbohej, dhe kështu u bë. Pavarësisht gjithë torturave,

Viktori refuzoi të heqë dorë nga feja e tij.

Në atë moment, Shën Korona (në atë kohë Korona), që ishte e pranishme në shesh dhe po shihte ngjarjen e tmerrshme, u prek shumë që një kristian i pafajshëm, po i nënshtrohej një brutaliteti aq të madh nga ushtarët e pasipirt romakë. Korona ishte në atë kohë një vajzë e re 16-vjeçare, dhe gruaja e një kolegu të Viktorit, që gjithashtu ndiqte në fshehtësi Krishterimin.

Ajo u afrua, nisi ta ngushëllonte dhe të lutej për të, dhe në të njëjtën kohë deklaroi para të gjithëve, se edhe ajo ishte një e krishterë krenare. Korona u arrestua menjëherë dhe u dërgua përpara gjyqtarit famëkeq Sebastian, që u tërbua nga inati me kthesën që kishin marrë ngjarjet.

Sebastiani nuk e mori aspak në konsideratë moshën e re të Koronës, apo faktin që ajo ishte femër. Për të mjaftonte që ajo ishte një e krishterë që e kishte kundërshtuar, prandaj meritonte ndëshkimin më të rreptë. Sidoqoftë, dënim i që dha për të, do të tmerronte edhe burrat më të guximshëm.

Sebastiani urdhëroi që majat e 2 palmave, të ndodhura njigjitur njëra-tjetrës, të përkuleshin drejt tokës me forcë, dhe të mbaheshin ashtu të lidhura me litarë. Pastaj ai urdhëroi ushtarët e tij t'i lidhin të dy krahët e Koronës me majat e përkulura të pemëve. Më pas, urdhëroi ushtarët të prisnin litarët.

Dy majat e palmave u kthyen me forcë në pozicionin e tyre, dhe

forca mjaftoi për të shqyer trupin e Koronës, duke i shkaktuar asaj një vdekje tepër të dhimbshme. Viktorit, që ishte ende gjallë, iu prek shumë që një kristian i pafajshëm, po i nënshtrohej një brutaliteti aq të madh nga ushtarët e pasipirt romakë. Korona ishte në atë kohë një vajzë e re 16-vjeçare, dhe gruaja e një kolegu të Viktorit, që gjithashtu ndiqte në fshehtësi Krishterimin.

Ajo u afrua, nisi ta ngushëllonte dhe të lutej për të, dhe në të njëjtën kohë deklaroi para të gjithëve, se edhe ajo ishte një e krishterë krenare. Korona u arrestua menjëherë dhe u dërgua përpara gjyqtarit famëkeq Sebastian, që u tërbua nga inati me kthesën që kishin marrë ngjarjet.

Sebastiani nuk e mori aspak në konsideratë moshën e re të Koronës, apo faktin që ajo ishte femër. Për të mjaftonte që ajo ishte një e krishterë që e kishte kundërshtuar, prandaj meritonte ndëshkimin më të rreptë. Sidoqoftë, dënim i që dha për të, do të tmerronte edhe burrat më të guximshëm.

Sebastiani urdhëroi që majat e 2 palmave, të ndodhura njigjitur njëra-tjetrës, të përkuleshin drejt tokës me forcë, dhe të mbaheshin ashtu të lidhura me litarë. Pastaj ai urdhëroi ushtarët e tij t'i lidhin të dy krahët e Koronës me majat e përkulura të pemëve. Më pas, urdhëroi ushtarët të prisnin litarët.

Dy majat e palmave u kthyen me forcë në pozicionin e tyre, dhe

që rrethon virusin.

Por mbi ngjarjen në fjalë, ka ende dyshime dhe spekulime. Edhe pse shumica e burimeve besojnë se ajo ka ndodhur në Siri, të tjerë thonë se të gjitha ngjarjet në fjalë kanë ndodhur në Antioki. Reliket që ndodhen sot në bazilikën e Anzu-së u ekzaminuan në vitin 1943, dhe sërisht në vitin 1981.

Nga ekzaminimet u vërtetua se eshtrat i përkasin një mashkulli dhe një femre. Ekzaminimet e vitit 1981, treguan praninë në eshtra të polenit të drurit të kedrit. Dhe hulumtimet e mëtejshme, zbuluan se ato duhet të kenë originën në Siri ose Qipro.

Këto prova mbështesin historisë popullore të Shën Koronës, që besohet nga njerëzit. Ndërkohë burimet greke pretendojnë se ngjarjet ndodhin gjatë mbretërimit të Perandorit Antoninus (138-161 Pas Krishtit), ndërsa burimet kopte thonë se ngjarjet kanë ndodhur gjatë mbretërimit të Dioklejanit (284 - 305 Pas Krishtit).

Edhe marrëdhënia midis Viktorit dhe Koronës, ndryshon në varësi të burimeve. Disa burime pretendojnë se Korona nuk ishte gruaja e një kolegu të Viktorit, por gruaja e tij; dhe se çifti u vra bashkë për shkak të besimit të tyre. Disa institucione katolike, pohuan se lutja ndaj Shën Koronës kundër pandemisë aktuale, ishte vendimi i duhur i besimtarëve, dhe ajo mund të ndihmojë në sigurimin e një zgjidhjeje në një situatë të vështirë. / guidebooktolife - bota.al



An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed on a dark blue background. Below it, a yellow box contains the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS' in large, bold, blue capital letters. On the left side, a dark blue box lists the 'Quality & Sales Award Recipients' in yellow text, with a note '(Listed in alphabetical order)'. The recipients include: ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality; Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality; Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy; Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality; Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality; Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales; Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality; Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality; Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality; and Soft Drinks Georgia Georgia, Sales. On the right side, there is a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola standing on a wooden surface against a dark blue background.

E jashtëzakonshme

Kapet peshku tri metra i gjatë, u shit 2 200 euro

Një peshk me gjatësi prej tri metrash, gjatësi kjo e cila po shënon rekord, është nxjerrë nga ujërat e Skocisë nga një grup peshkatarësh britanikë. Peshku u shit më pas për 2 200 euro, për të cilin sugjerohet se kishte më shumë se 134 kilogramë, shkruan "Daily Star". Krijesa e detit i përkët tashmë një firme për tregtimin e peshqve në Manchester të Anglisë, e cila planifikon ta ndajë atë në 100 pjesë dhe ta shesë përmish.



FOTO E DITES



Kalaja e Ali Pashë Tepelenës në Butrint

Një shqiptare në mesin e 150 grave që po ndryshojnë Italinë

Me kalimin e kohës, "Gratë e pamposhtura" janë bërë një kolonë editoriale dhe një komunitet, prej rreth 2,000 grash e vajzash. StartupItalia ka publikuar listën e 150 "grave të pamposhtura" që po ndryshojnë Italinë, përvitin 2020.

Në listën e gjatë është edhe Anita Likmeta. Lindur në Durrës, Shqipëri, ajo u transferua në Itali me familjen, në moshën 11-vjeçare – së pari, në qytetin Pescara dhe më vonë në Romë,

ku ndoqi akademinë "Corrado Pani", shkrujnë mediet italiane. Në vitin 2011, Likmeta u transferua në Paris, ku ajo do të zhvillojë esenë mbi historinë, me tezën nën drejtimin e profesorit Giancarlo Giordano, përmarrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë, në periudhën nga 1922 deri në vitin 1943.

Gjithmonë në Paris, ajo një një realitet kulturor që solli bashkë-drejtimin e një dokumentari me drejtorin francez Kourtrajmë

Mohamed Mazouz, ku edhe intervistoi kandidatin për çmimin "Nobel" në letërsi dhe bashkatdhetarin Ismail Kadare, artistin Kiki Picasso, artistin italjan Tanino Liberatore, si dhe politikanin francez, Francois Asselineau.

Më 13 tetor të vitit 2013, gazeta "Il Fatto Quotidiano" boton një artikull të saj, ku Likmeta flet përmarrëdhëmin që e solli atë në Itali dhe vizionin e saj në lidhje me politikat e imigracionit. Nga

janari 2014, shkruan në "Huffington Post". Nga prilli deri në gusht 2015, bashkëpunoi në faqen kulturnore "IlGiornaleOff" të "Il Giornale".

Likmeta është diplomuar për letërsi dhe filozofi, pranë Universitetit të Romës, "La Sapienza". Ajo është historiane dhe filozofe, me pasionin përmarrëdhëmin dixhital. Merret me gazetari, film dokumentar, teksta njihet edhe si blogere,



autore tekstesh etj. "E pamposhtur", Anita Likmeta, radhitet kështu mes 150 grave më të fuqishme, të cilat, po ndryshojnë shtetin fqinj, me vizionin dhe punën e çdonjëres. /Konica.al /



DASHI
Dita do të jetë e mirë, pasi janë një seri yjesh në shenjë që ju mbështetin. Duhet të tregoheni më i vendosur.



DEMI
Pritet një ditë në të cilën do të jeni i dhënë kryesisht pas punës dhe do të bëni mirë. Është më mirë të jeni të rezervuar.



BINJAKËT
Do të jetë një ditë shumë e favorshme sa iu takon çështjeve tuaja të punës dhe atyre familjare. Mund të bashkëvepronit me persona të cilët do t'ju ndihmojnë në punët tuaja.



GAFORRJA
Sot do të jetë një ditë e qetë, ngrojtësia e familjes do t'ju japë shëtysë të bisedoni me ta një çështje që ju mundonte prej kohësh.



LUANI
Do të keni aftësi të mira menaxhuese. Në punë do të arrini më shpejt sesa keni menduar në objektivat finale.



VIRGJËRESHA
Duhet të jeni më i kujdesshëm gjatë kohës që nisni të blini produkte të ndryshme. Mund të përfundoni duke blerë të njëjtat gjëra dy herë.



PESHORJA
Dita do të nisë më së miri, por se si do të përfundojë varet nga ju. Mos prisni që zgjidhjet e problemeve të vijnë vetë.



AKREPI
Dobësítë tuaja mund të jenë dualiteti, konfuzioni dhe përzierja e ndjenjave të cilat do t'ju ngatërojnë mendimet.



SHIGJETARI
Jo çdoherë që keni një problem duhet ta ktheni në një tragedji. Njerëzit rrötull jush nuk kanë pse t'i dëgjojnë ankesat tuaja, edhe përsituatat më të parëndësishme.



BRICJAPI
Dita do të nisë më së miri, por se si do të përfundojë, varet nga ju. Mos prisni që zgjidhjet e problemeve të vijnë vetë.



UJORI
Pranoni çdo mundësi që do t'ju vijë pa e menduar gjatë, pasi diçka e madhe po vjen për ju.



PESHQIT
Duhet t'i lini pretendimet, në të kundërt do të humbisni një kontratë shumë të rëndësishme.

BARSOLETA E DITËS



Flasin dy gjyshe:

- Sa peshon? - e pyet njëra.
- Me syze, 80 kilogramë.
- E pa syze?
- Eh, pa syze, nuk e shoh peshoren!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Një asteroid i afrohet tokës më shumë se çdo trup kozmik ndonjëherë

Një asteroid ka fluturuar në afersi të tokës, i cili besohet të jetë trupi kozmik që i është afruar më së shumti planetit ndonjëherë. Objekti i vogël, i njohur si

asteroid 2020 QG, qëndronte vetëm 3000 kilometra larg Oqeanit Indian jugor, ka njoftuar agjencia e hapësirës NASA. Trupi qellor kishte gjatësinë e një makine.

Kanye West do të sjellë një version të ri të TikTok-ut



Gjatë një fjalimi, presidenti i Shteteteve të Bashkuara, Donald Trump, bëri me dije se ka ndërmend ta ndalojë aplikacionin TikTok në ShBA, shkruajnë mediat e huaja. Gjithashtu, ai do ta bllokojë edhe Microsoftin ta firmosë marrëveshjen për ta blerë këtë aplikacion nga prodhuesit kinezë. E nëpërmjet një postimi në "Twitter",


Kanye West ka deklaruar se ka ndërmend të sjellë një version të ri të TikTok-ut. Kësaj radhe aplikacioni do të quhet Jesus Tok dhe do të ketë përbajtje të kontrolluar, në mënyrë që edhe fëmijët ta përdorin lirshëm këtë aplikacion. Ky frymëzim i erdhi reperit teksa po shikonte video të ndryshme në Tik Tok së bashku me vajzën e tij.

Fifi pranon komplimente nga fansat, pas ndryshimit të madh në pamje



Këngëtarja e njohur shqiptare Filloreta Raçi-Fifi i ka habitur të gjithë me ndryshimin e madh në pamje. Ajo ka humbur shumë kilogram dhe në fotot e reja që i publikoi më pas mezi njihet nga fansat. Këta të fundit nuk po ndalojnë së dhëni komplimente

drejt Fifit dhe këtë e bënë edhe pranë postimit të disa fotografive të reja të cilat ajo i ka ndarë me ndjekësit në "Instagram". Fifi është shumë e dashur për publikun edhe përfaktin se është person shumë i afërt me njerëzit. Veçohet, po ashtu, edhe për zërin e saj.



Partnerja e Ronaldos, provokuese, vesh fustan të ngushtë

Cristiano Ronaldo dhe partnerja e tij Georgina në fillim të pandemisë siguroheshin që të rrinë në shtëpi dhe të ruhet ndaj Covid-19, por kohët e fundit i kanë shpeshtuar shëtitjet dhe duket se po kalojnë mirë në vendet bregdetare. Georgina nuk po


ndalon me publikimin e imazheve të ndryshme e para disa minutash publikoi një momentin intim duke u puthur me Ronaldon. Tani e ka ndarë me ndjekësit një foto, e veshur me një fustan të bardhë dhe të ngushtë i cili i vinte në pah format trupore.

Ledri dhe Sara takohen me prindërit e Dua Lipës në Mal të Zi



Ledri Vula dhe e dashura e tij Sara Hoxha tani kanë zgjedhur që t'i kalojnë disa ditë pushimi në Malin e Zi. Të dy janë aktivë në rrjete sociale dhe shpesh publikojnë imazhe të ndryshme duke u argëtuar. Së

fundmi Ledri e ka ndarë me ndjekësit një fotografi ku shihet me Sarën, prindërit e Dua Lipës dhe vëllanë e saj Gjinin. Bazuar në këtë fotografi shihet se ata po argëtohen shumë së bashku.



Shtyhet për të premten ndeshja Tre Penn - Gjilan

Ndeshja në mes të Tre Pennes dhe Gjilanit në Ligën e Evropës është shtyrë për sot (e premte), pasi një futbollist i klubit nga Kosova rezultoi pozitiv me Covid-19. "UEFA njofton se ndeshja do të zhvillohet të premten, ku para zhvillimit të saj do të ritestohen të gjithë futbollistët dhe stafi, përvèç rastit i cili ka dalë pozitiv në testimin e të mërkurës dhe rasti i kontaktit të tij", thuhet në njoftimin e Gjilanit

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 GUSHT - Ndeshja në mes të Tre Pennes dhe Gjilanit në kuadër të raundit preliminar në Ligën e Evropës do të zhvillohet sot (e premte) nga ora 18:00. Kjo ndeshje ishte paraparë të zhvillohet të enjten nga ora 21:00, por është shtyrë nga UEFA për shkak se një futbollist i Gjilanit ka dalë pozitiv me Covid-19. "UEFA njofton se ndeshja do të zhvillohet. Tri klubet që e



përfaqësojnë Kosovën në garat ndërkombëtare, Drita, Prishtina dhe Gjilani janë përballur me problemin e infektimit të futbollistëve me virusin "Corona". Siç dihet, kampionia e Kosovës, Drita, u eliminua nga Liga e Kampionëve, pasi disa lojtarë të saj u konfirmuan pozitivë me Covid-19 para ndeshjes finale në rrethin parakualifikues kundër

Lindfieldit. Edhe Prishtina pati telashe, pasi u anulua ndeshja kundër Lincolnit në Ligën e Evropës, e cila ishte parashikuar të zhvillohet të mërkurën. Kjo ndeshje do të zhvillohet të shtunën nga ora 18:00, kurse për ekipin kryeqytetas do të drejtohet nga Ramiz Krasniqi dhe do të përfaqësoshet nga lojtarë të shumë klubeve të Superligës.

FC Prishtina falënderon Lincolnin

FC Prishtina e ka falënderuar kundërshtarin në Ligën e Evropës, Lincoln, pasi kjo e fundit ka pranuar çdo kërkesë të klubit më të madh të Kosovës. Ndeshja në mes të këtyre dy skuadrave do të zhvillohet nesër (e shtunë). "Për asnjë çast skuadra vendase e Lincolnit nuk ka hezituar që të na ndihmojë me çdo kërkesë që kemi pasur, për çka ne jemi shumë falënderues ndaj zyrtarëve të kësaj skuadre si në organizimin e ndeshjes së parë, po ashtu edhe në përpjekjen për organizimin e ndeshjes së dytë. Skuadra nikoqire e Lincolnit pa hezituar fare e ka pranuar kërkesën tonë që ndeshja të zhvillohet të shtunën. FC Prishtina pafundësisht u është mirënjohës zyrtarëve të skuadrës së Lincolnit", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Së shpejti do të themelohet liga mbarëshqiptare e basketbollit



PRISHTINË, 20 GUSHT - Basketboli shqiptar së shpejti do ta ketë ligën mbarëkombëtare. Për këtë gjë, të enjten ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në takim drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës, i kryesuar nga Arben Fetahu. Në këtë takim koordinues u diskutua përmarrëveshjen që pritet të nënshkruhet mes Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për themelimin e Ligës Mbarëkombëtare Shqiptare të Basketbollit, e cila mundëson zhvillimin e garave në mes të klubeve të Kosovës dhe

Shqipërisë. Kryetari Fetahu e njoftoi ministrin Dumoshi se orientimi është pjesën e parë të shtatorit marrëveshja pritet të nënshkruhet në Tiranë mes dy federatave në praninë e ministreve homologe. Kryetari i FBK-së e informoi ministrin edhe për problemet me të cilat po ballafaqohen basketbollistët dhe federata për shkak të pandemisë. "Po presin kur autoritetet do ta lejojnë zhvillimin e stërvitjeve dhe garave nëpër palestra dhe menjëherë t'i fillojnë përgatitjet për sezonin e ri", ka thënë Fetahu.

Nga ana e saj, ministrja Dumoshi u shpreh se mirëpret nismën për themelimin e Ligës Mbarëkombëtare dhe MKRS-ja është e gatshme që të mbështesë këtë ligë në bazzë të kapaciteteve të mundshme të saj. "Në koordinim me autoritetet përgjegjëse shtetërore, do të angazhohet që sa më shpejt që është e mundur të lejohet një garave për sezonin e ri në basketboll. Ministria i informoi drejtuesit e FBK-së edhe përmështetjen që do ta kenë basketbollistët nga fondi emergjent i MKRS-së, ku ata pritet të përfitojnë drejtësëdrejt", ka thënë ministrja Dumoshi.

Llapi 'blindon' tre yje

Podujevë, 20 gusht - KF Llapi ka arritur marrëveshje përvazhdimin e kontratës me tre futbollistë: Mentor Zhdrella, Bujar Idrizi dhe Valmir Veliu. Zhdrella dhe Idrizi kanë nënshkruar kontrata njëvjeçare, ndërsa Veliu për tri vjet. "Kemi arritur marrëveshje njëvjeçare me kapitenin Mentor Zhdrella dhe zëvendëskapitenin Bujar Idrizi. Të dy futbollistët i qëndruan besnikë skuadrës edhe për edicionin e ri. Zhdrella ishte ndër futbollistët më të mirë të skuadrës



në edicionin që lamë pas duke ndihmuar skuadrën me 5 gola dhe 9 asistime në 24 paraqitje të zhvilluara, kurse Bujar Idrizi i rikuperuar plotësisht nga lëndimi i edicionit të kaluar, zhvilloi 8 paraqitje, kurse do të jetë i gatshëm 100 % që ta ndihmojë skuadrën në edicionin e ri. Sulmuesi 20-vjeçar i krahut të majtë, Valmir Veliu, është 'blinduar' me kontratë edhe për tri vjetët e ardhshëm dhe kësosoj Veliu do të

ketë formë të mirë dhe të na ndihmojë edhe më tepër në edicionin e ri", thuhet në njoftimin e Llapit.

Pnishi përforcon Feronikelin

Ish-kampioni i Kosovës në futboll, Feronikeli, është përforuar me reprezentuesin e Kosovës, Alban Pnishi. "FC Feronikeli ka vazhduar përforcimin e skuadrës, duke

prekur se cilin repart të fushës. Kësaj radhe është përforcuar vija e mbrojtjes, duke sjellë në skuadër një qendërmbranjës të reprezentacionit, Alban Pnishi", thuhet në njoftimin e Feronikelit. Më parë, Pnishi ishte pjesë e skuadrave Wohlen dhe Grasshoppers në Zvicër dhe në fund ishte pjesë e skuadrës së Bnei Yehuda në Izrael. Ai ka edhe paraqitje me reprezentacionin e Kosovës, kurse Feronikeli shpreson që përvaja e tij të jetë e dobishme për skuadrën.

Flick: Lyoni na i vështirësoi gjërat, PSG-ja ekip fantastik

MUNCHEN, 20 GUSHT - Trajneri i Bayern Muchenit, Hansi Flick, kërkon suksesin e trefishtë në sezonin e tij të parë si trajner i gjigantëve të Gjermanisë. Pavarësisht fitores 3-0 ndaj Lyonit, Flick vlerësoi maksimalisht skuadrën e Rudi Garcias. "E dinim se do të

ishte e vështirë, pasi ata vinin pas paraqitjeve shumë të mira kundër Manchester Cityt dhe Juventusit. Lyoni është një ekip shumë i fortë në aspektin taktik dhe na hapi probleme. E dinim se duhet të mbronim mirë dhe të mos e humbnim topin lehtë, por na ndodhi që

e humbëm", ka thënë Flick për "Sky Sport". Më pas tekniku gjerman foli edhe për finalen e së dielës kundër Paris Saint Germain. "PSG-ja është një ekip i shkëlqyer dhe do të analizojmë disa gjëra. E dimë që ata kanë lojtarë shumë të shpejtë. Do të shikojmë ta

organizojmë mbrojtjen, por e dimë që forca jonë më e madhe është vënia në presion e kundërshtarit. Thomas Tuchel është duke bërë një punë shumë të mirë me francezët. E kam vizituar një herë dhe e kam parë që po punon mirë. Tani le të



mendojmë për ndeshjen e së dielës".

Sonte finalja e Ligës së Evropës, Sevilla - Inter

KOLN, 20 GUSHT - Finalja e Ligës së Evropës, Sevilla - Inter, do të luhet sonte (e premte) premtes, 21 gusht, në stadiumin e Kolnit në Gjermani. Kujtojmë se Interi është e para skuadër italiane që prek finalen e kësaj gare në 21 vjetët e fundit. Një rrugë deri më tanë perfekte për Interin e Antonio Conte në këtë kompeticion kontinental. Pasi eliminuan Getafen dhe Bayer Leverkusen, zikaltrit rrënuan Shakhtar Donetskun me një paraqitje të mrekullueshme force, firmosur nga çifti supersulmues Lukaku-Lautaro. Finalja luhet sonte dhe parashikon kohë shtesë, madje edhe goditje penaltish, në rast të një barazimi. Interi më në fund ka rizbuluar golat evropianë të Lautaro Martinez. Argjentinasi është shfaqur përsëri si protagonist, duke lënë pas periudhën jo të mirë, mbas bllokimit të koronavirusit. Në krah të tij, Lukaku i zakonshëm, "lokotivë" e vërtetë e skuadrës italiane me 33 gola sezonalë, në vitin e parë aty. Belgu mund të përpuneth me numrat e Ronaldos (Fenomeni), i cili në sezonin 1997-



1998 shënoi golin e tij të 34-të sezonit në finalen e Kupës UEFA, raporton "Telesport". Sevilla është një "hit" i vazhdueshëm i këtij kompeticioni. Skuadra andaluziane eliminoi Romën në 1/8 finale, Wolverhamptoni në çerekfinale dhe Manchester Unitedi në gjysmëfinale, duke treguar futboll spektakolar herë pas here. Sa iu përket formacioneve të mundshme, Lopetegui do të vijoje me modulin 4-3-3. Rikonfirmohen

ish-ët kuqezinj, Ocampos dhe Suso, në korsitë e jashtme të sulmit. Strumbullari i sulmit do të jetë En Nesyri, me ish-interistin Banega, që kompleton mesfushën përkrah Fernando dhe Jordan. Jesus Navas u ringjall nga e djathta me Reguilón në të majtë. Diego Carlos, shtylla mbrojtëse, para portierit Bounou. Si zakonisht, Antonio Conte do t'i besojë 3-5-2 dhe çiftit të tij të mrekullueshëm të golit: Lukaku-Lautaro. Këta të dy do t'i udhëheqin zikaltrit në finale, pas provës së shkëlqyer të ofruar në gjysmëfinale. Gagliardini favorizohet për një vend titullari para Eriksen, ndërsa Baston dhe Godin konrmohen në mbrojtje përkrah De Vrij. Sanchez është një element mjaft i mirë për bankën rezervë.

FORMATACIONET E MUNDSHME

Sevilla (4-3-3): Bounou; Jesus Navas, Kounde, Diego Carlos, Reguilón; Banega, Fernando, Jordan; Ocampos, En-Nesyri, Suso.
Inter (3-5-2): Handanović; Godin, De Vrij, Bastoni; D'Ambrosio, Barella, Brozović, Gagliardini, Young; Lukaku, Lautaro Martinez.

Flick: Lyoni na i vështirësoi gjërat, PSG-ja ekip fantastik

MUNCHEN, 20 GUSHT - Trajneri i Bayern Muchenit, Hansi Flick, kërkon suksesin e trefishtë në sezonin e tij të parë si trajner i gjigantëve të Gjermanisë. Pavarësisht fitores 3-0 ndaj Lyonit, Flick vlerësoi maksimalisht skuadrën e Rudi Garcias. "E dinim se do të ishte e vështirë, pasi ata vinin pas paraqitjeve shumë të mira kundër Manchester Cityt dhe Juventusit. Lyoni është një ekip shumë i fortë në aspektin taktik dhe na hapi prob-



leme. E dinim se duhet të mbronim mirë dhe të mos e humbnim topin lehtë, por na ndodhi që e humbëm", ka thënë Flick për "Sky Sport". Më pas tekniku gjerman foli edhe për

finalen e së dielës kundër Paris Saint Germain. "PSG-ja është një ekip i shkëlqyer dhe do të analizojmë disa gjëra. E dimë që ata kanë lojtarë shumë të shpejtë. Do të shikojmë ta organizojmë mbrojtjen, por e dimë që forca jonë më e madhe është vënia në presion e kundërshtarit. Thomas Tuchel është duke bërë një punë shumë të mirë me francezët. E kam vizituar një herë dhe e kam parë që po punon mirë. Tani le të mendojmë për ndeshjen e së dielës".

Ferizaj sot fillon përgatitjet

FERIZAJ, 20 GUSHT - Skuadra e Ferizajt do të fillojë sot (e premte) përgatitjet për sezonin e ri futbollistik. Stërvitja do të drejtotohet nga trajneri Burim Çerkini.

"Të premten në ora 17:30 në stadiumin e qytetit në Ferizaj skuadra jonë do të mbajë një takim në mes drejtoret të klubit dhe futbollistëve për të diskutu-

ar rreth sezonit të ri dhe fillimin e stërvitjeve. Stërvitjet pritet t'i udhëheqë trajneri Burim Çerkini. Shpresojmë që gjatë ditëve në vazhdim të vendoset një orga-

nizim i klubit tonë, kur dihet që kampionati fillon pas dy javësh, dhe nga klub i ynë janë larguar shumica e futbollistëve që ishin pjesë e klubit në sezonin e kalu-

ar", thuhet në njoftimin e Ferizajt. Siç dihet Ferizaj nuk ka arritur të sigurojë mbijetesën në IPKO Superligë dhe sezonin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë.

SHKURT

Daniele Orsato drejton finalen Bayern - PSG

Gjyqtari italian Daniele Orsato do ta drejtojë finalen e Ligës së Kampionëve në të mes Bayern Muchenit dhe PSG-së. UEFA ka zgjedhur pikërisht "bilbilin" e njohur për të ndarë drejtësi në supersfidën e së dielës në mbrëmje. Asistentët e Orsato në fushën e blertë do të janë Manganelli dhe Giallatini. Në dhomën e VAR-it do të pozicionohen Massimiliano Irrati dhe Marco Guida. Rumani Ovidiu Hategan, gjyqtari i katërt, dhe dy spanjollët pas portave, Perez Palomar dhe Hernandez Hernandez, do ta kompletosnjë tërë grupin e "bluzave të zeza" të finales së Ligës së Kampionëve. Italiani i fundit që drejtoi një finale të tillë ishte Rizzoli më 2013 (Bayern-Dortmund 2-1). Më parë, këtë nder e kishin pasur italianë të tjerë si Braschi, Collina, Lanese, Agnolin dhe Lo Bello.

Silva, afër rikthimit në Serinë A

Thiago Silva mund të rikthehet në Serinë A, por jo tek ish-klubi i Milanit, por te Fiorentina e Frack Ribery. Fiorentina e Commissos dëshiron të jetë protagoniste në tregun e transferimeve të verës me emra të rëndësishëm. Drejtuesit duan një ekip me talentë të ndërthurur me lojtarë me përvjosi si Ribery dhe i dyti në listë pritet të jetë Thiago Silva. Shtypi italian shkruan se klub i vjollcë ka marrë pëlqimin nga mbrojtësi brazilian për t'u transferuar pas përfundimit të finales së Ligës së Kampionëve. Marrëveshja mes palëve është pranë për një kontratë dyvjeçare, ku mbrojtësi do të përfitojë 4 milionë euro në vit.

Izolohen gjashtë futbollistë te Cagliarit

Jo vetëm te Roma të prekur me Covid-19. Edhe te Cagliari ka futbollistë të infektuar, madje janë katër të infektuar. Ata janë testuar para nisjes së përgatitjeve dhe në fund Filip Bradariq, Luca Ceppitelli dhe Alberto Cerri kanë dalë pozitivë, pasi më parë kishte pasur të njëtin fat edhe Kiril Despodov. Ky i fundit ishte infektuar gjatë pushimeve në Bullgari, kurse të tjerët në Sardenjë. Sipas protokollit, këta futbollistë dhe dy lojtarë të tjerë që kishin qenë në kontakt të ngushtë me ta, janë izoluar për të mos rrezikuar infektimin e të tjerë personave në klub. Kjo situatë e krijuar ka bërë që edhe fillimi i përgatitjeve të shtyhet për këta lojtarë, kurse pjesa tjeter e futbollistëve pritet të zbresë në fushë dhe të stërvitet për nisjen e sezonit të ri futbollistik.


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:133231
Datë: 09.07.2020
Numri i dokumentit: 01017332

C.nr.113/2018

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i juridike të paditësit Bajram Sadik Cakaj nga fshati Xërxe, komuna Rahovecit, i cili i përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Teki Bokshi nga Gjakova, kundër të paditurit Jovan Ljubomir Stankovic që parë nga fshati Xërxe, komuna e Rahovecit, tani i shpërëngulur në shtetet e jashtme me adresë të pa njeri, përshtakëtë vërtetimit të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri, vlera e kontestuarë shumë prej 5.000,00 Euro më dt. 09.07.2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Jovan Ljubomir Stankovic që parë nga fshati Xërxe, komuna e Rahovecit, tani i shpërëngulur në shtetet e jashtme me adresë të pa njeri, i CAKTOHET përfaqësuesja e përkohshme avokate Arta Himaj nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesja e përkohshme i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushqiron deri sa të kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpaljeve të gjykatës.

A r s y ë t i m

Paditësi Bajram Sadik Cakaj nga fshati Xërxe, komuna e Rahovecit, i cili i përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Teki Bokshi nga Gjakova, ka ushtruar padi për të vërtetimin e së drejtës së pronësisë në paluajtshmëri kundër të paditurit Jovan Ljubomir Stankovic që parë nga fshati Xërxe, komuna e Rahovecit, tani i shpërëngulur në shtetet e jashtme me adresë të pa njeri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se i padituri është i shpërëngulur në botën e jashtme dhe përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka propozuar që në këtë çështje kontestimore të caktojë një përfaqësues të përkohshëm që i njejti t'i mbrojë të drejtat deri sa të paraqitet në gjykatë vërejtë e paditura respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën përcaktimin e kujdestarin.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit që i përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata, gjeti se janë pëtësuar kushtet nga neni 79.3 e LPK-së, që i caktimini e përfaqësuesit të përkohshëm

Numri i lëndës: 2019:133231
Datë: 09.07.2020
Numri i dokumentit: 01017332

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet makesa në afazinë 15 ditëve, nga ditë e pranimit. Arkesa ushtrohen përmes gjykatës gjykatë, përgjykëtë Apelit, Divizioni Civil i Përgjithshme.



Republic of Kosovo
Basic Court in Gjakova – Court Branch in Rahovec

Case No. 2019:133231
Date: 09/07/2020
Document No. 01017332

C.No. 113/2018

The BASIC COURT IN GJAKOVA – Court Branch in Rahovec, General Department – Civil Division, with judge Betim Behluli, has decided in the legal case of the plaintiff: Bajram Sadik Cakaj from the village Xërxe, Municipality of Rahovec, represented by his authorized person Teki Bokshi, lawyer from Gjakova against the respondent: Jovan Ljubomir Stankovic former from the village Xërxe, Municipality of Rahovec, now living abroad the state with unknown address, regarding the verification of the property right of a real estate, on the 9th of July 2020, as follows:

DECISION

For the respondent Jovan Ljubomir Stankovic, former from the village Xërxe, Municipality of Rahovec, now living abroad the state with unknown address, is APPOINTED a temporary representative: Arta Himaj, lawyer from Rahovec.

Within the meaning of Article 82 of the Law on Contested Procedure (LCP), the temporary representative has all the rights and obligations of the legal representative which he or she exercises until the respondent court or its representative is present. The Custodian Body notifies the court that it has appointed the custodian.

This ruling will be announced in the official gazette, in one of the daily newspapers and in the court announcement table.

Reasoning

The plaintiff Bajram Sadik Cakaj from the village Xërxe, Municipality of Rahovec, represented by his authorized person, Teki Bokshi, lawyer from Gjakova, has filed a lawsuit against the respondent Jovan Ljubomir Stankovic, former from the village Xërxe, Municipality of Rahovec, now living abroad the state with unknown address, referring the verification of the property right of a real estate.

The court has attempted to hand over to the respondent now lives abroad the state and his authorized representative of the plaintiff has proposed to the court to appoint a temporary representative to the respondent to defend his rights till the respondent appears personally at the court or till the custody organ informs the court for having appointed a custodian.

Case No. 2019:133231
Date: 09/07/2020
Document No. 01017332

Acting conform the proposal of the authorized person of the plaintiff, the court has found that the disposition of this ruling in accordance with the provisions of Article 79.3 of the Law on Contested Procedure to appoint a temporary representative and lawyer Arta Himaj from Rahovec has declared to agree that she will temporary represent the respondent in the above mentioned legal-civil case.

It has been decided as in the dispositive of this decision.

BASIC COURT IN GJAKOVA – Court Branch in Rahovec
 C.No. 113/2018, dated 09th of July 2020

The judge
 Betim Behluli
 (Round stamp and signature)

LEGAL ADVICE:

There can be raised up a complaint against this Judgment in a timeframe of 15 days in the Supreme Court of Kosovo in Pristina on behalf of this Court.



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR ZYRE PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informata mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Referencia lidhur me furnizimin me material shpenzues.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garacionin dhe cilësinë e furnizimeve.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të myllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejës, pn. (magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2020 nga ora 14:00-15:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.org



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME DERIVATE TË NAFTËS DHE BENZINËS PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informata mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Referencia lidhur me furnizimin me derivate.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garacionin dhe cilësinë e furnizimeve.
- Cilësia e furnizimit të derivateve të jetë në harmoni me Udhëzimin Administrativ 01/2017- MTI

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të myllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejës, pn. (magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2020 nga ora 10:00-11:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

- Meralj Hamza shpall te pavlefshme diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren
- Sultane Arifi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Veton Mekan shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- Altin Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Nazmi Kokollari Budakova" Prizren
- Mentor Qafleshi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Fadil Hisari" Prizren
- Behar Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Mendim Gashi nga Prishtina, shpallë të pavlefshme dëftesat e klasës së -X- dhe -XI- te shkollës "Sami Frashëri" Prishtinë
- Jap banesë me qira afér 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulqian katër i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulqian katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentish kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardana afér "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër të prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rezhi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania **TABANLIOGLU MIMARLIK DANISMANLIK LIMITED SIRKETI** “Dega në Kosovë” me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të unik: **811367798** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedures së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazette.

OBAVEŠTENJE

Obavještavamo svi klienti da Tvrka **TABANLIOGLU MIMARLIK DANISMANLIK LIMITED SIRKETI** “Dega në Kosovë u Prizren”, doneo odluku da ugasi biznis po br. Registra: **811367798** I ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **TABANLIOGLU MIMARLIK DANISMANLIK LIMITED SIRKETI** “Dega në Kosovë in Prizren” has come to the decision to quit its business with registry: **811367798**. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët e SH.P.K.,“Kualitet Prizreni” me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznisin me numër të rexhistrimit: 71223760 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim e procedurës së Likuidimit.Njoftojmë gjithë klientët që kanë raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditor nga data e shpalljes në gazette.

OBAVEŠTENJE

Obavještavamo sve klijente da Tvrka SHPK.,“Kualitet Prizreni” u Prizrenu doneo odluku da ugasi biznis po br.registr: 71223760 I ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije.Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze I potrazivanja u navedenoj firmi,da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja u novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company „Kualitet Prizreni” LLC in Prizren has come to the decision to quit its business with registry : 71223760.The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process.All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina
**GJIMNAZI I FILOLOGjisë “EQREM ÇABEJ”
NË PRISHTINË**



Nr. prot. 279

Datë: 20.08.2020

TENDER

Me të cilin ftohen kompanitë e interesuara që të konkurrojnë përfurnizimin e nxënësve të shkollës sonë me uniforma shkolllore unike.

Ofertuesi duhet të paraqesë këto dokumente të nevojshme:

1. Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë përkatëse.
2. Çmimi i uniformës.
3. Referencë e ushtrimit të veprimtarisë së tillë.

Oferta mbetet e hapur 7 ditë prej shpalljes së saj në mjetet e informimit publik.

Të interesuarit, ofertat i dorëzojnë drejtësorejt në shkollë.

Prishtinë, më 20.08.2020

Nga komisioni

NJOFTIM

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshepte

ANNOUNCEMENT

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË